

## ***Dixhitalizimi, transparenca dhe besimi publik: Mundësitë dhe sfidat e KLSH-së***

*nga Vjollca Selmani- Audituese, KLSH  
botuar në gazetën "Telegraf", më 5 janar 2018*

Tranzicioni i gjatë dhe i vështirë që vendi ynë po kalon prej gati tre dekadash, si dhe debatet e shumta mediatike mbi nivelin e lartë të korrupsionit në organet e drejtësisë si dhe në institucionet shtetërore e kanë sflitur besimin e njerëzve ndaj transparencës dhe efikasitetit të punës së këtyre institucioneve. Tendenca e përfitimive korruptive po rrënon më tej besimin publik duke krijuar një situatë tepër shqetësuese ku të gjithë, në një formë apo në një tjetër, humbasim kolektivisht. Besimi publik ndaj institucioneve shtetërore shërben si një katalizator i fuqishëm për avancimin e reformave në të gjitha hallkat e qeverisjes, prandaj ringritja e këtij besimi mbi baza të shëndosha mbetet një nga prioritetet kryesore, pa të cilin këto reforma vështirë që mund të arrijnë objektivat e planifikuara.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka një rol kyç në rifitim të besimit tek institucionet shtetërore duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në lidhje me përdorimin e fondeve publike. Transparenca promovon parimet themelore demokratike, që ndikojnë pozitivisht për të shndërruar cinizmin mbizotërues të qytetarëve ndaj qeverisjes në një pjesëmarrje aktive të tyre në debatet për çështjet publike. Gjithashtu, transparenca rrit përgjegjshmërinë dhe përkujdesjen e administratës publike në menaxhimin e fondeve publike. KLSH synon të sigurojë që në të gjitha transaksionet ku përfshihen shpenzime publike, të mbizotërojnë transparenca dhe përgjegjësi në mënyre që të fitohet besimi i publikut.

Ndërkohë, vendi ynë është përfshirë në revolucionin mbarëbotëror të dixhitalizimit, i cili parashikohet të transformojë tërësisht pjesën dërmuese të aktivitetit njerëzor. Shpesh herë, dixhitalizimi perceptohet si një burim i pashmangshëm i transparencës. Sa është kjo e vërtetë? Gjithashtu, në kushtet kur dixhitalizimi është ende në hapat fillestare, është shumë e rëndësishme të shtrohet pyetja se cili do të jetë impakti i këtyre transformimeve në besimin e njerëzve tek institucionet publike? Si mund të ndihmojë procesi i dixhitalizimit në kryerjen sa më mirë të misionit të KLSH-s?

Dixhitalizimi ofron mundësi të mëdha për ndryshime të qëndrueshme që synojnë përmirësimin e besueshmërisë së marrëdhënieve midis individëve, organizatave dhe institucioneve publike. Zhvillimi i jashtëzakonshëm i mediave sociale, e-government, revolucionin e katërt industrial ose *Industry 4.0* (si do të revolucionarizohet prodhimi industrial nga interneti i objekteve), janë faktorë që favorizojnë transparencën e shkëmbimeve ekonomike dhe sociale. Por, problemet e shkëmbimeve në një kontekst dixhital janë ngushtësisht të lidhura me ato të shkëmbimeve në një kontekst tradicional (analog). Një shoqëri ku tradicionalisht mbizotëron fryma e mosbesimit, do të 'trashëgojë' eventualisht këtë mosbesim dhe në botën e dixhitalizuar. E thënë ndryshe, dixhitalizimi nuk është një shkop magjik që zgjidh menjëherë problemet aktuale shumë akute. Përkundrazi, ai mund t'i thellojë ato në rast se nuk merren masat e nevojshme për të kuptuar e kontrolluar ecurinë e këtij procesi me të gjitha pasojat e tij. Rritja e manipulimeve në sektorin financiar dhe ekonomik, sulmet kibernetike të natyrave të ndryshme, rastet e plagjiaturës dhe falsifikimit janë disa nga rreziqet që shoqërojnë procesin e dixhitalizimit dhe që dëmtojnë besimin e përdoruesve të shërbimeve dixhitale.

Disa faktorë të tjerë që lidhen me menaxhimin e teknologjive të reja, shkaktojnë krizë besimi tek përdoruesit e tyre. Kështu për shëmbull, mungesa e rregullave dhe standarteve të qarta të lojës shkakton reaksione të forta në pranimin e modeleve të reja të biznesit. Kjo po ndodh për shëmbull me platformat dixhitale Uber ose Airbnb. Kujtojmë këtu se Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka vendosur që platforma dixhitale Uber të konsiderohet si kompani transporti për sa shfrytëzon aplikacione të ndryshme për ofrimin e shërbimeve në fushën e transportit. A po veprojnë këto kompani – platforma dixhitale në përputhje me rregullat e normat e lojës ekonomike? A po ushtrojnë këto platforma një konkurrencë të ndershme ndaj ndërmarrjeve të taksive apo të hotelerise? Meqë besimi shkatërrohet shumë më shpejt se sa ndërtohet, mosnjohja e dinamikave të adoptimit të teknologjive të reja dhe indiferenca ndaj tyre mund të sjellin pasoja shumë negative në lidhje me të ardhmen e sektoreve të prekur nga këto teknologji.

Një shëmbull tjetër i tensionit ndërmjet avantazheve dhe disavantazheve të dixhitalizimit është ai që lidhet me *datafikimin* (një pjesë gjithmonë e më e madhe e informacioneve ‘*datafikohet*’ ose shndërrohet në ‘*të dhëna dixhitale*’). *Datafikimi* e prek drejtëpërsdrejti misionin e KLSH-s. Nga njëra anë, datafikimi përmirëson praktikën e kontrollit duke mundësuar aksesin në të dhënat e ndryshme që kanë mundësi të rrisin transparencën e aktiviteteve të institucioneve publike. Duke pasur më shumë të dhëna që lidhen me zbatimin e aktiviteteve publike mundësohet analiza e këtyre aktiviteteve e mbështetur në evidencën faktuale (***Evidence-based approach***). Efektiviteti i kësaj mënyre analize është provuar gjërësisht në fusha nga më të ndryshmet (nga mjekësia deri në administratën publike). Si rrjedhojë, transparenca më e madhe do të ndikojë pozitivisht në një besim më të madh të qytetarëve në këto institucione.

Por, nga ana tjetër, *datafikimi* ushtron presion për ndryshimin (zgjerimin) e mandatit të KLSH-s duke tërhequr vëmendjen në rrezikun e sulmeve kibernetike. *Datafikimi* rrit mundësinë e ‘*rrjedhjes*’ së informacionit në mënyrë të paautorizuar dhe për pasojë rrezikon aktivitetet e personave fizikë apo juridikë aktiviteti i të cilëve lidhet me këto të dhëna. Sa të sigurta ndaj sulmeve kibernetike janë shërbimet qeveritare të dixhitalizuara? Një tjetër shtysë për zgjerimin e mandatit ‘*tradicional*’ të KLSH-s është dhe nevoja për të matur njëherazi efikasitetin dhe koherencën e iniciativave publike të dixhitalizimit. Në ç’masë këto iniciativa kanë realizuar objektivat e tyre për përmirësimin e shërbimeve qeveritare? Në ç’masë këto iniciativa janë komplementare, pra plotësojnë njëra-tjetrën?

Sikurse rezultojnë nga përvoja ndërkombëtare, shumë shpesh, suksesi i një projekti apo programi është i ndërlidhur me suksesin e një projekti apo programi tjetër. Mosrespektimi i këtij parimi ekonomik që quhet ‘*supermodularitet*’ sjell humbje të mëdha në dy drejtime: **i)** në se nuk zhvillohen njëkohësisht projektet komplementare, asnjëri prej tyre nuk do të jetë efikas sa dhe si duhet; **ii)** gjithashtu, ndodh shpesh, kur konstatohet mungesa e efikasitetit të një programi, në vend që të investohet në drejtim të projekteve që janë komplementare me të, ndërpritet projekti i avancuar, duke çuar dëm fondet e përdorura për të. Parimi i ‘*supermodularitetit*’ është shumë i pranishëm në kushtet e dixhitalizimit. Kështu për shëmbull, duhet të sigurohemi që rritja e numrit dhe nivelit të automatizimit të shërbimeve qeveritare dixhitale të realizohet paralelisht me programet që garantojnë sigurinë e informacioneve qeveritare si dhe me programet që vendosin përdoruesit e këtyre shërbimeve (qytetarët) në qëndër të strategjisë qeveritare të dixhitalizimit. Në se njëri nga këto aspekte injorohet, kompromentohet në mënyrë të pashmangshme suksesi i aspekteve të tjera.

Një kontribut të veçantë në përcaktimin e hapave të mëtejshëm të KLSH-s ndaj dixhitalizimit, kanë shkëmbimet e experiencave ndërkombëtare në këtë fushë. Vende të ndryshme të

EUROSAT-t po përpiqen të përcaktojë një seri optimale praktikash që synojnë zgjerimin e hapësirave të kontrollit dhe rritjen e efikasitetit të tij përmes dixhitalizimit. Bashkëpunimi ndër-institucional, brenda dhe jashtë vendit, është një domosdoshmëri që kushtëzohet nga fakti që dixhitalizimit është një proces kompleks ngushtësisht i lidhur me konceptin e *network-ut* (rrjetit). Shkëmbimi i praktikave të pjesëmarrësve të ndryshëm të *network-ut* ndihmon në identifikimin e praktikave më të mira që në një fazë të dytë (kur teknologjia dhe efektet e saj të njihen më mirë) mund të standartizohen.

Kështu për shëmbull, në kërkim të praktikave më të mira të auditimit të *e-government*, një grup pune mbi teknologjitë e informacionit (IT) i përbërë nga disa vende të EUROSAT-t, ka sugjeruar krijimin e një *'intelligent database'* në internet në të cilën mund të depozitohen raportet e auditimit të *e-government* nga vende anëtare të SAI si dhe artikuj, prezantime, metodologji e materiale të tjera që lidhen me praktikën e kontrollit dixhital. Ideja është që të mundësohen kështu analiza të thella për menaxhimin efikas të kontrollit të dixhitalizuar, rastet e rrezikut që shoqërojnë përdorimin e tij, si dhe projekte të ardhshme që paraqesin interes në këtë fushë. Ky *'brainstorming'* kolektiv është dizenuar në mënyrë të tillë që të angazhojë në diskutim jo vetëm auditet publikë që punojnë në fushën e *e-government*, por dhe të gjitha palët e përfshira në auditimin modern të IT-së.

Zgjedhjet e duhura të objektivave dhe praktikave të punës së KLSH-s në funksion të dixhitalizimit, mund të arrihen në se do të mbështeten në themele të sigurta si:

- 1) ***Një strategji afatmesme e menaxhimit të transformimeve dixhitale të objektivave dhe praktikave të KLSH-s*** – e konsideruar si një e tërë dhe gjithëpërfshirëse për të evituar parcelizimin e punës dhe përpjekjeve.
- 2) ***Zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme njerëzore (know-how) në përputhje me njohuritë dhe eksperiencat e duhura për të vënë në zbatim me sukses mënyrat e reja të punës*** – ku pavarësisht avancimit të shpejtë të teknologjive dixhitale, qofshin ato në infrastrukturë (interneti apo telefonia mobile), në hardware, software *'intelligent machines'* (makinat që mësojnë); njeriu do të mbetet pjesa qendrore e sistemeve ekonomike dhe sociale.
- 3) ***Vullnet të fuqishëm institucional dhe vijmësi në formulimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të transformimit kërkon.*** Në këto kushte, vetëm dëshira e mirë është e pamjaftueshme për të sjellë frutat e duhura nga adoptimi i inovacioneve teknologjike, prandaj kërkohet inisiativë, adoptim dhe përdorim i kujdesshëm i teknologjive dixhitale nëpërmjet programeve të zbatuara me rigorozitet.

Rruga drejt transformimeve është e gjatë dhe e vështirë. Suksesi kërkon parapërgatitje institucionale shumë-planëshe dhe bashkëpunim me të gjithë përdoruesit / përfituesit e *eko-sistemit dixhital*. Por, sa më herët të kapet roli i leadershipit në rrugën e transformimeve, aq më frutëdhënës do të jetë përdorimi i këtyre teknologjive inovative. Historia e zhvillimeve teknologjike ka provuar se sa më shpejtë të kapen dhe të adaptohen arritjet inovative, krijohet një avantazh konkurrues shumë i rëndësishëm që vështirë të mund të kapet nga të vonuarit. Dhe ne kemi gjithë besimin e vullnetin e duhur për të qenë në vagonat e parë të këtyre transformimeve.

## **“Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm publik – hallka e 4<sup>t</sup> e domosdoshme e procesit të auditimit”**

nga Aulona Jonuzi, Kryeaudituese, KLSH  
botuar në gazetën “Koha Jone” më 19 janar 2018.

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit, procesi i zbatimit të rekomandimeve kryhet për cdo vit dhe ka për qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH, në subjektet e audituara dhe përcaktimin e shkallës së zbatueshmërisë së tyre. Ai konsiderohet si hallka e 4<sup>t</sup> e procesit të auditimit (pas planifikimit, auditimit në terren dhe raportimit). Cdo praktikë e auditimit në sektorin publik, është e destinuar të mbart mangësi/të meta, nëse në të nuk përfshihen proceset e njohura të “folloë-up”-it. Nëse qasjet e auditimit e kushtëzojnë veten deri në zbulimin e parregullsive, duke mos treguar më tej asnjë potencial zhvillimi, në përfundim këto qasje do të reduktohen në një teknikë institucionale jo –kreative. Madje mund të konkludohet se, qëllimi final i synuar nga auditimi i jashtëm publik ka gjasa të humbasë, nëse rekomandimet e lëna nuk ndiqen me efektivitet (që do të thotë monitorim dhe angazhim maksimal deri në zbatimin e plotë të tyre).

Fokusi i këtij shkrimi është zbatueshmëria e masave disiplinore, si element i rëndësishëm dhe me ndikim në përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar në tërësi, pasi lidhet pikërisht me nxjerrjen e përgjegjësive individuale për shkeljet e konstatuara dhe dhënien e masave në raport me to.

Gjatë procesit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, mbi auditimet e KLSH-së, t kryera përgjatë 3 mujorit të fundit të vitit 2016 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2017, u konstatua se masat disiplinore janë dhënë në referencë të shkeljeve: në fushën e prokurimeve; ose në procedurat e dhënies me qera; apo mungesës së koordinimit të kërkesave individuale për projektet në zhvillim me strategjitë institucionale të zhvillimeve rajonale dhe sektoriale që kanë sjellë favorizim të projekteve, të cilat nuk kanë rezultuar me ndikim në interesat e shtetit; etj. Në disa raste, titullarit të institucionit i është lënë në kompetencë vlerësimi, nxjerrja e përgjegjësive dhe dhënia e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, ku na ka rezultuar se në ato raste kur vendosja e masës është lënë në dorë të titullarëve, ose nuk është vepruar për zbatimin e rekomandimit; ose në rastet kur është vepruar janë ngritur *komisione disiplinore* brenda institucioneve respektive, të cilat në fakt kanë marrë vendimin “Ndërprerje e ecurisë disiplinore”. Në të dy skenarët e ndjekur (pra si në rastin e mosveprimit ashtu edhe në atë të veprimit) rezultati ka qenë i njëjtë: **Nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.**

***Është paksa paradoksale të mendosh që nga njëra anë pranohen rekomandimet mbi shkeljet për të cilat kërkohet edhe marrja e masave disiplinore, ndërsa nga ana tjetër nuk vepronet për zbatimin e rekomandimeve mbi marrjen e masave disiplinore, ose ecuria disiplinore vendoset të ndërpritet. Gjithë sa më sipër do të thotë që pranohet të ketë parregullsi, por përgjegjësia mbetet kolektive.***

Nëse komisionet disiplinore vendosin ndërprerje të ecurisë disiplinore, a do të thotë kjo që rekomandimet e KLSH-së nuk qëndrojnë? E nëse po, sa gjasa ka që në pothuajse të gjitha rastet kur vendosja e masave disiplinore lihet në dorë të titullarëve, ose ecuria disiplinore është ndërprerë ose nuk është vepruar fare?

Çështja merr rëndësi të veçantë pasi nëpërmjet këtyre masave, synohet të kërkohet marrja përsipër e përgjegjësive individuale për kryerjen e një shkeljeje me apo pa dëm ekonomik. Në fakt “paraja” është vetëm një nga matësit e rëndësishëm, por jo domosdoshmërisht më i rëndësishmi. Në këtë kontekst, kur bëhet fjalë veçanërisht për rekomandime në sektorë kyç, ose me impakt të lartë në mjedis, apo në cilësinë e jetës së qytetarëve, apo të ngjashme si këto,

ndjekja e zbatueshmërisë së tyre kërkon angazhim maksimal nga SAI dhe nga audituesit, si dhe vëmendje të veçante sidomos ndaj rekomandimeve kyçe për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Në këto kushte, praktikat e GAO-s na shërbejnë më së miri, duke na udhëzuar se pikërisht në **këto raste kërkesa për zbatimin e rekomandimeve duhet të ngrihet në mënyrë progresive në nivele më të larta menaxheriale**<sup>1</sup>.

**KLSH si një institucion që aplikon Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI-të, si edhe tërësisht e hapur ndaj praktikave më të mira të fushës, e konsideron zbatimin e rekomandimeve si pjesë organike të procesit të auditimit.** ISSAI 12 “Vlerat dhe Përfitimet e SAI-eve – bërja e ndryshimit në jetët e qytetarëve”, konsideron SAI-n si një aktor udhëheqës në sistemin menaxhimit financiar në tërësi, përtej roleve dhe përgjegjësive tradicionale të tyre. Është interesante se si ISSAI 12 e trajton “auditimin e jashtëm publik” si një faktor të rëndësishëm që sjell ndryshimin në jetën e qytetarëve. Edhe në këtë dokument theksohet rëndësia e ndjekjes së rekomandimeve ku parashikohet se, *SAI duhet të ketë mekanizma për ndjekjen e rekomandimeve.*

Në vijim, **parimi i 3-të, që GAO ndjek përgjatë zbatimit të rekomandimeve “Aplikim i kujdesshëm i një monitorimi të shëndoshë dhe i sistemit “folloë-up”, parashikon se, audituesit duhet të sigurohen që subjektet të kenë sisteme “folloë-up”-i që përmbushin në mënyrën e duhur përgjegjësitë themelore të tyre për zgjidhjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

Po në referencë të praktikave të SHBA-ve, përgjegjësia e agjencive për të implementuar rekomandimet buron pikërisht nga Ligji për Kontabilitetin dhe auditimit, i cili daton që më 1950<sup>2</sup>, i cili citon se, *përgjegjësia primare për përmirësimin e operacioneve, ku nevoja për këtë të fundit diktohet nga puna audituese, mbetet brenda menaxhimit të vetë agjencisë.*

Në përfundim, gjykoj se sado i lartë të jetë niveli i angazhimit të SAI-t në procesin e zbatimit të rekomandimeve, zbatueshmëria e plotë e tyre kërkon njëkohësisht angazhim po aq të lartë edhe nga subjektet e audituara, sepse duhen të dyja anët, për të ngritur “ura të forta” sigurie dhe besueshmërie në funksion të përmirësimit të jetëve të qytetarëve.

E nëse angazhimi i këtyre të fundit nuk mjafton për të zbatuar rekomandimet e auditimit të jashtëm publik, atëherë kërkesa për zbatimin e rekomandimeve duhet të ngrihet në nivelet më të larta menaxheriale. Aty ku mungon angazhimi individual, duhet një vullnet që buron nga lart-poshtë, gjithëpërfshirës e detyrues. Aktualisht mungesa e nxjerrjes së një Urdhri nga Kryeministri mbi dhënien e një vlere detyruese zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së riskon të favorizojë antikulturën e pandëshkueshmërisë.

---

<sup>1</sup> GAO/ 9.2.1 “Si tw ndjekim rekomandimet e dhwna”

<sup>2</sup> Pwrgjegjwsia primare pwr pwrmirwsimin e operacioneve, ku nevoja pwr kwtw wshtw diktuara nga puna audituese, qëndron brenda menaxhimit tw agjencise. Ndwrsa pwrgjegjwsia kyce e audituesit wshtw tw bwjw rekomandime konstruktive dhe tw ndjekw zbatimin e tyre, me qwllim vlerësimin nwse rezultatet e kërkuar ajanw arritur.

## Edhe njëherë për problemet e shqetësimet e Ujësellsave sha

nga Niko Nako –Kryeauditues, KLSH  
botuar në gazetën “Telegraf”, më 19 janar 2018.

*Në se pa energji elektrike mund të rrish edhe 1 javë, pa ujë nuk mund të rish as 1 ditë, ku çmimi dhe fatura e ujit nuk shkon më tepër se 1 kafe në ditë dhe kur UJI është jetik për njerëzit, atëherë pse nuk paguhet ? I pengon mentaliteti i Shqiptarit se pritet falja e radhës, pa mundësia për të paguar-apo mungesa e organizimit dhe zbatimi i ligjit, më tepër qëndron kjo e fundit*

Probleme për zgjidhje në Ujësellesa sha, ka shume. Ne armaten prej mbi **5400** punonjësve që numërojnë aktualisht Ujësellesat sha, ka specialiste, inxhinere Hidro te talentuar dhe mjeshtra punonjës Ujësjellësi sha me mjaft përvojë, por ata ose nuk i pyet kush ose pajtohen me gjendjen e këtyre Shoqërive. Nuk duhen shkurtuar punonjësit por duhet të administrohet dhe paguhet gjithë uji i konsumuar. Nga mos kontrolli dhe kërkesa e llogarisë e Degëve teknike dhe veçanërisht të Drejtuesve të këtyre Shoqërive, duke përfutur edhe nga fakti që matësit e ujit janë vendosur në shkallët e pallateve nuk janë të sigurte nga ndërhyrjet apo çplumbosja e tyre duke bërë ndërhyrje në matësat e ujit, madje ka raste që faturohen sasi uji njësoj si një fabrikë e cila shpenzon me mijra m<sup>3</sup> në ditë me një qytetar të thjesht që ka vetëm 1 çezmë dhe i faturohet 1m<sup>3</sup> ne ditë, pa haruar lavazhet, lidhjet dytësore etj.

Në 56 Shoqëritë e Ujësjellësve sha, në shkallë vendi janë punësuar rreth 5,400 punonjës duke shpenzuar vetëm për pagesën e Këshillave Mbikëqyrëse mesatarisht rreth 45- 50 milion lekë /vit. Nga numri prej 5400 punonjës rreth 40% e zënë 5 Ujësjellsat sha, respektivisht: Tirana 1170 punonjës, Durrësi 605 punonjës, Feri 302, Berati 249, Shkodër 226 punonjës etj.

**Nga auditimet e ushtruara nga KLSH ka rezultuar se kuadri ligjor dhe nënligjor për rregullimin veprimtarisë tyre nuk është i plotë, në mjaft Shoqëri anonime të Ujësellsave kanë rezultuar mjaft shkelje ku mund të përmendim:**

**Së pari:**

**Kuadri ligjor në fuqi për Ujësjellsat sha:**

Para transferimit të ish-ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime në pushtetin vendor, veprimtaria e Këshillave Mbikëqyrëse rregullohej bazuar në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, ndryshuar me VKM nr.677, datë 3.10.2007 dhe VKM nr. 215, datë 28.3.2012. Pas daljes së VKM nr. 660, datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore” dhe një sërë vendimesh të tjera të mëvonshme u bë transferimi i aksioneve dhe pronave nga Ministria e Ekonomisë në pushtetin vendor duke ndryshuar edhe statusit juridik nga ish-ndërmarrje shtetërore në shoqëri anonime shtetërore shkurt sha. Duke bërë edhe regjistrimin në QKR.

**Pra në asnjë nga 3 VKM e mësipërme nuk përcaktohet qartë:**

- Ku klasifikohen Ujësjellsat sha në Shoqëri strategjike, jo strategjike, apo jostrategjike vendore.
- Si do të bëhet shpërblymi (pagesa) e Këshillave Mbikëqyrës, mbi bazën e përqindjes së pagës Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes apo meqenëse aksionet janë transferuar në pushtetin vendor të paguhet në përqindje mbi pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës.
- Si do të bëhet pagesa dhe sa e sekretarit të këshillit mbikëqyrës.

**A. Për gjendjen e krijuar** me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 137, datë 30.09.2015 përcjellë me shkresën nr. 527/217 date 10.10.2015, KLSH bazuar në nenin 18-Revokimi dhe ndryshimi i akteve, të ligjit nr.154/2014, datë 22.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, dhe nenin 26, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 ”Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, **u ka rekomanduar 3 Ministrive, respektivisht:** Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe e Infrastrukturës. Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Ministrinë e Financave, **rekomandime konkrete. Nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes të ndërrmeret insiativa për :**

a) Ndryshimin e Ligjit nr. 10 264, datë 8.4.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar në nenin 8, duke kërkuar **shfuqizimin** e pikës nr. 1.a. te nenit 8, në të cilën përcaktohet që “1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave” dhe neni 8 të riformulohet:

“Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrëse të shoqërive aksionare shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MZHETTS) si më poshtë:

b) 1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

c) 2/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

b) rishikimin dhe ripunimin thelbesor të kuadrit rregullator me synim hartimin një Vendimi të ri të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimi të ri duke reflektuar të gjitha problematikat e këtyrë 15 viteve pasi si VKM nr 642 datë 11.10.2005 i ndryshuar me VKM nr 677 datë 03.10.2007 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore dhe ne Udhëzimin e Ministrit nr 318 datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” datojnë që para daljes së Ligjit nr. 10264, datë 08.04.2010.

c) Në funksion të unifikimit të mënyrës së pagesës së anëtarëve dhe sekretarëve të Këshillit Mbikqyrës të Ujësjiellës-Kanalizime sh.a, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrinë e Financave, që të ndërmarrin nismën ligjore dhe të paraqesin në Këshillin e Ministrave, projekt-vendim mbi mënyrën dhe masën e pagesës së anëtarëve dhe sekretarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Ujësjiellës-Kanalizime sh.a, kryesisht në rregullimin e problemeve të mëposhtme:

-Shoqëritë e Ujësjiellës sh.a, aksionet e të cilëve janë transferuar në pushtetin vendor të mos klasifikohen si Shoqëri Strategjike, por si Shoqëri jo strategjike vendore, pasi nuk mund të konsiderohet shoqëri strategjike një Ujësjiellës me 10 punonjës.

-Pagesa e Këshillave Mbikëqyrës të mos kushtëzohet nga paga e Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës, por nga tregues të tjerë, si numri i punonjësve, xhiroja apo volumi i shitjeve të ujit, etj.

-Pagesa e sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës të vendoset për pjesëmarrjen në çdo mbledhje të zhvilluar dhe jo pagë fikse mujore, njëkohësisht të jetë punonjës i Shoqërisë.

-Në këtë kuadër të bëhet edhe rregullimi i sistemit të pagave të Shoqërive të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a, duke vendosur kufij maksimalë për pagat e punonjësve dhe veçanërisht unifikimin e pagave të administratës dhe drejtorit të shoqërisë në vendosjen raporteve të drejta me pagat e punonjësve. Kjo pasi u konstatuan raste të caktimit të pagës së drejtorit të shoqërisë nga ana e Këshillit Mbikëqyrës në nivele mjaft të larta; përmendim rastin e Ujësjiellës sh.a Puke-Fshat ku paga e Drejtorit ishte caktuar 90 000 lekë/muaj, ndër 26hë që shoqëria kishte gjithsej 10 punonjës.

-Të rishikohet numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, me synim reduktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, pasi si shoqëritë me 10 punonjës dhe ato me mbi 600 punonjës kanë të njëjtin numër prej 6 anëtarësh.

Nga auditimet e kryera nga KLSH për pagesën e bordeve dhe Këshillave Mbikëqyrëse ka rezultuar se në 14 Ujësjiellës sha janë kryer pagesa të tepërta duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën



**5,183,375 lekë, ku përmendim;** Ujësjiellësi sh.a Fier në vlerën 1.440.278 lekë, Durrës në vlerën 421,589 lekë, Fushë-Krujë në vlerën 246 713 lekë, Elbasan-Qytet, në vlerën 741,895 lekë, Patos në vlerën 486,698 lekë, Mirditë në vlerën 1,044,402 lekë, Ura Vajgurore në vlerën 251,100 lekë, etj. - **Nga 56 Ujësjiellës** sh.a, në shkallë vendi 44 Ujësjiellës sh.a i kanë paguar **sekretarët** e Këshillit më tepër se përcaktimi në udhëzim e Ministrisë Ekonomisë, duke shkaktuar buxheteve të Ujësjiellësve sh.a një dëm ekonomik në **vlerën 1,552,070 lekë**.

#### Së dyti:

Gjatë auditimit është konstatuar se disa antarë të këshillave Mbikëqyrëse të 8 Ujësjiellsave sha, përfaqësues të Bashkive ndodhen në kushtet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private dhe konkretisht:

Në Këshillat Mbikëqyrëse të 8 Ujësjiellsave rreth 14 ish-Kryetarë Bashkie dhe Komune duke qenë në pozicionet e kryetarit të Bashkisë apo Komunës, njëherazi nga Asambletë e Aksionarëve apo Këshillat Bashkiake (kur ka qenë vetëm 1 aksionar), KLSH dyshon se këto raste janë në gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari. Kjo në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, neni 29 -Kufizimet për kryetarin e bashkisë, të komunës dhe të Këshillit të qarkut,shkronja a) ku përcaktohet se: Kryetarët e Bashkive dhe Komunave nuk mund të jenë Drejtues ose anëtarë të organeve Drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tij.

Për rastet e gjendjes në kushtet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private, KLSH bazuar marrëveshjen e nënshkruar më datën 02.03.2012 ndërmjet Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive përfaqësuar nga Kryeinspektori dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" neni 8- Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë, KLSH me shkresën nr. 527/176 datë 31.07.2015 **i ka ofruar Inspektoratit** të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, informacionin për dyshime se janë në gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari për 15 persona.

*Do vendoset faksimale pjese e skanuar e Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 137, datë 30.09.2015 dhe shkreses KLSH nr. 527/217 date 10.10.2015 derguar 3 Ministrive respektivisht: Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe e Infrastrukturës. Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Ministrinë e Financave*

#### **-Mbi auditimet e ushtruara nga KLSH në shoqëritë e Ujësjiellës Kanalizime SHA.**

Për vitet 2016-2017, nga Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike, janë audituar mjaft shoqëri Ujësjiellës Kanalizime SHA. Nga auditimet e kryera kanë rezultuar dëme ekonomike të konsiderueshme në vlerën **180,597 mijë lekë** dhe shpenzime dhe/ose të ardhura jo në përputhje me parimet e economicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në vlerën **18,399 milion lekë**.

Për shpërdorime me dëm ekonomik të konstatuara nga auditimet e KLSH, **përmendim:** Ujësjiellës Kanalizime SHA Durrës për vitin 2016 me një dëm ekonomik në vlerën 15,001 mijë lekë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec për vitin 2016 me një dëm ekonomik në vlerën 3,757 mijë lekë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Tiranë për vitin 2017 me një dëm ekonomik në vlerën 95,931 mijë lekë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Lushnjë për vitin 2017 me një dëm ekonomik në vlerën 47,619 mijë lekë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Shkodër për vitin 2016 me një dëm ekonomik në vlerën 1,930 mijë lekë etj.

Nga ana e KLSH për rastet e abuzimeve në Ujësjiellës SHA gjatë kësaj periudhe përveç se është rekomanduar dëmshpërblimi i dëmit në masën 100%, në disa raste janë dërguar në organet e Prokurorisë duke kërkuar Kallëzime Penale për nivele të larta drejtuesish e konkretisht: për



Drejtorin e Ujësjetllësi SHA Korçë, Drejtorin e Ujësjetllës Kanalizime SHA Durrës, Drejtorin e Ujësjetllës Kanalizime SHA Lushnjë etj.

### **Por çfarë është bërë pas 2 vjetësh në zbatim të rekomandimeve të KLSH?**

Si fillim u pranuan rekomandimet e KLSH dhe me Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", u shfuqizuan 3 VKM e mëparshme respektivisht VKM nr. 642, datë 11.10.2005 "Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës", ndryshuar me VKM nr. 677, datë 3.10.2007, VKM nr. 215, datë 28.3.2012. dhe VKM nr. 660, datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjetllësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore

Në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 ndër të tjera në statutet e këtyre Shoqërive, aksionet e tyre u janë transferuar përkohësisht Këshillave Bashkiake dhe nuk do ketë më Këshilla Mbikëqyrëse, por si struktura drejtimi përveç Drejtorisë do funksionojnë Këshillat e Administrimit me 3 persona.

**Sipas nenit 5 të Statutit Tip të Ujësjetllës sha**, Organet e shoqërisë së ujësjetllës-kanalizimeve sh.a., janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

c) Administratori (Drejtori i shoqërisë) dhe nga ky i fundit zgjidhen 2 drejtorë njëri për anën teknike dhe tjetri për anën ekonomike

Neni 6, Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

5. Bashkitë dhe shoqëritë e ujësjetllës-kanalizimeve sh.a., janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë /detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjetllës-kanalizimeve dhe ish-njësive të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

Edhe pse kane kaluar 2 vjet që ka dale Vendimi i Këshillit Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", gjendja e Ujësjetllësve sha është si më parë dhe në mos më keq. Ky vendim në pamje të parë duket sikur sjell një gjë të re duke lidhur kontrata ndërmjet administratorit të Shoqërie Ujësjetllës sha pra Drejtorit me Këshillin e Administrimit (kontratë e cila ka egzistuar edhe më parë me Këshillin Mbikëqyrës) dhe një kontratë ndërmjet Bashkisë dhe Ministrisë së Linjës e cila është pa vlerë juridike, pasi Ujësjetllsat sha janë Shoqëri anonime dhe janë të pavarura në vendimarrjen e tyre.

Ky vendim sipas rekomandimit të KLSH, nuk ka vendosur klasifikimin e Ujësjetllësve sha, nuk ka vendosur kriteret për përcaktimin e pagave të administratës dhe Drejtorit (administratorit shoqërisë), nuk është bërë një riklasifikim dhe nuk është vendosur një tabelë orientuese të pagave dhe aktualisht një punëtor i thjeshtë në Ujësjetllës sha, paguhet jo më tepër se 25,000 lekë muaj, kurse administrata mbi 50.000-70,000 leke muaj, drejtori i shoqërisë varion mbi 80,000 deri 120,000 leke muaj, si ne Puke me 10 punonjës dhe ne Durrës me 650 punonjës.

B.Një problem social teje i mprehte është mos pagesa nga ana e mjaft Shoqërive të Ujësellsve të kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e tyre, ku një pjese e mire e tyre janë ne prag pensioni, ngarkesa me kamat vonesa, mbytja me borxhe nga OSHE për mos pagesën e energjisë elektrike, e cila në Ujësellsat sha me ngritje mekanike paguhet me çmim biznesi 14 lekë/kv.

Sipas të dhënave jo zyrtare më datën 31.12.2017 borxhet e energjisë elektrike shkojnë në mbi **8,713,106,468 lekë**, nga të cilat 2,843,784,890 janë kamat vonesa. Kreditë afat gjata të mara për ndërtimet e mjaft Ujësellsave të rinj nga Banka Gjermane (KfV), mbytja e 5-6 prej tyre me borxhe dhe kredi afat gjata, për blerjen e të ashtuquajturve, Matesit e ujit (sahatet) me Uarles, me “komandim ne distance”, si ne Ujësellsit sha, Berat, Korçë, Pogradec, Lushnjë, Fier, dhe asnjë Këshill Bashkiak nuk është ulur dhe ka parë efektivitetin e marjes se këtyre kredive, përveç defekteve dhe problematikave që ato kanë shfaqur. Për gjendjen e kredive nuk publikohen shumat e principialit dhe interesat bankare që paguajnë Ujësellsat sha, apo Qeveria për këto Kredi afat gjate. Duhet në **riskedulim** të këtyre borxheve, por kështu edhe gjendja e lartë e faturave të papaguara.

Probleme ka edhe me mos pagesën e detyrimeve tatimore, ku në kushtet e llogaritjes nga sistemi elektronik kamat vonesat kanë shkuar në “stratosferë”. Ndërsa subvencionet për vitin 2017 nga 650,000,000 lekë të parashikuara janë dhënë vetëm gjysma e tyre ose në vlerën 287,242,385 mijë lekë, etj.

**Nuk ka nevojë për reforma të mëdha dhe “ndëshkim” personash që bëjnë lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, apo nuk paguajnë faturat e ujit të pijshëm, por më parë duhet të japin llogari administratat dhe veçanërisht Drejtorët (Administratorët) e Shoqërive të Ujësellsave sh.a, Këshillat e Administrimit, të cilët nuk e kanë kryer punën për të cilën paguhet dhe me veprimet apo mosveprimet e tyre (pasi kuadri ligjor ka ekzistuar por nuk zbatohet) kanë lejuar lidhjet e paligjshme duke ligjëruar “vjedhjen” e vlerës së ujit të pijshëm, pra zbatimi i ligjit duhet të fillojë nga këta të fundit, pastaj të kalojnë tek qytetarët. Mos meret si shembull energjia elektrike ku u ndëshkuan qytetarët dhe asnjë drejtues i OSHE apo Zyrrave të Shpërndarjes Energjisë Elektrike në rrethe, nuk u vu para përgjegjësisë ligjore.**

Kuadri ligjor dhe nënligjor për administrimin e ujit të pijshëm ekziston por ai nuk po gjen zbatim dhe me të po abuzohet pasi ndaj abonentëve të cilët nuk paguajnë faturat e ujit të pijshëm nuk u është kryer ndërprerja e ujit të pijshëm, siç parashikohet në VKM nr. 236, datë 10.05.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjarë dhe jo familjar” i ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.2.2007 dhe Udhëzimi i Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 03, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditësh, ndërmarrja e ujësellsit ndërpret furnizimin me ujë. Shpenzimet e kryera nga ndërmarrja e ujësellsit, për rilidhjen e konsumatorit me rrjetin e furnizimit me ujë, të përballohen nga konsumatori.**

*Një shkrim të botuar në Gazetën Telegraf më datë 23 dhjetor 2014, pra para 3 vjetësh është trajtuar edhe gjendja e lartë e debitorëve në Ujësellsa sha, duke bërë thirrje publike Qeverisë që duke e përshëndetur ndërhyrjen e fuqishme për ndërprerjet e paligjshme dhe pagesat e faturave të prapambetura të energjisë elektrike të vazhdojë edhe për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme dhe pagesat e faturave të papaguara për ujin e pijshëm pra debitorët e ujësellsëve sha. Nga shoqëritë e Ujësellsave duhet të përgatiten njoftimet me shkrim për secilin abonent, pasi një pjesë e tyre neglizhojnë, ose jetojnë jashtë vendit dhe nuk janë në gjendje të njihen me detyrimet për faturat e ujit të pijshëm.*

*Me rekomandimin dhe ndërhyrjen e audituesve të KLSH, gjatë periudhës së auditimit në Ujësells sh.a, Berat-Kuçovë u krijuan grupe pune, u bënë njoftimet në TV-Lokale dhe u bë e mundur që të dyfishohet arkëtimi i debitorëve të ujit të pijshëm nga 100,000-150,000 lekë në ditë u arkëtuan 300,000-500,000 lekë në ditë dhe në total u arkëtuan mbi 5,000,000 lekë. Ja pra që ende ka rezerva*

*në këtë drejtim. Në këtë shkrim shtohet pyetja, Se mos mbas debitorëve të energjisë duhet të vazhdohet edhe me debitorët e ujit të pijshëm, sidomos bizneset.?*

Për gjendjen financiare të Ujësellsave SHA të marin më tepër përgjegjësi Bashkitë si pronare dhe zotërues të aksioneve, Enti Rregullator i Ujit në lidhje me përcaktimin e politikës çmimeve, Ministria e Linjës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësellsave Kanalizimeve ku kjo e fundit të mos “ngopet me lugë bosh” dhe jep “dekorata” me shifrat e pyetësorët për treguesit e performancës që grumbullon çdo tremujor nga 59 shoqëritë e Ujësellsave, por të analizojë në vazhdimësi performancën e tyre, gjendjen e lartë të debitorëve të ujit të pijshëm duke propozuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes, si ristrukturimi i borxheve për faturat e papaguara nga abonentët familjarë apo jo familjarë (Bizneset). Furnizimi me matësat e ujit të pijshëm në mënyrë të përqendruar dhe jo tu lihet në dorë vendosja e tyre punonjësve të Ujësellsave, se në vendosjen e tyre po abuzohet dhe dikush po pasurohet.

Edhe pse jo analizimi i gjendjes së Ujësellsave SHA në mbledhjet më të afërme të Këshillave Bashkiake duke dalë me një plan veprimi konkret. Ujin na e ka falur natyra, ne duhet ta administrojmë.

## **CILËSIA E AJRIT NË SHQIPËRI**

nga Aulent Guri- Kryeauditues, KLSH  
botuar në gazetën “Koha Jone”, me 8 shkurt 2018.

Në zbatim të planit vjetor dhe programit të auditimit nr. 682/4, datë 06.10.2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, realizoi auditimin e performancës me temë “Cilësia e Ajrit”. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Berat, Drejtorinë Rajonale Shëndetësore Berat. Ky ishte një auditim paralel ndërkombëtar (*EUROSAI Cooperative Audit on Air Quality*) i cili u udhëhoq nga SAI holandez në bashkëpunim me SAI-n e Polonisë si dhe ekspertëve të Gjykatës Evropiane të Llogarive, ku morën pjesë rreth 16 SAI nga vende të ndryshme të Evropës. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat nr. 682/5, 6, 7, 8 datë 30.11.2017 iu dërgua projektraporti i auditimit institucioneve subjekt auditimi. Me Vendimin nr. 203, datë 29.12.2017 të Kryetarit të KLSH-së, është miratuar Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës me temë “Cilësia e Ajrit dhe me shkresën nr. 682/13, datë 29.12.2018, i janë përcjellë institucioneve subjekt i këtij auditimi, rekomandimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar se, qeverisja qendrore dhe lokale në Shqipëri kanë dështuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Edhe pse në 2014 është miratuar Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e saj. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe si rrjedhojë, asnjë bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit në të cilin analizohen në detaje problemet dhe masat që duhen marrë për eliminimin e tyre. Substancat kryesore që ndikojnë në cilësinë e ajrit në Shqipëri janë grimcat e imta (*PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>*), dioksidi i squfurit, benzeni, monoksidi i karbonit, plumbi dhe ozoni troposferik. Këto substanca janë të përcaktuara si ndotësit kryesorë të ajrit nga OBSH dhe janë të parashikuara edhe në Direktivën e Cilësisë së Ajrit 2008/50/EC. Monitorimi i cilësisë së ajrit (detyrim i

Agjencisë Kombëtare të Mjedisit - AKM dhe Institutit të Shëndetit Publik - ISHP) nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së dhe aktet ligjore e nënligjore të vendit tonë. Së pari, duhet theksuar që i gjithë procesi i monitorimit të cilësisë së ajrit është i paakredituar dhe shumë laboratorë për elementë të ndryshëm si për shembull për grimcat e imta (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>) janë të pa kalibruar çka dëshmon qartë për nivelin e ulët të besueshmërisë së të dhënave që paraqiten në Raportet e Gjendjes së Mjedisit që publikohen çdo vit nga AKM. Gabimi në nxjerrjen e të dhënave që ato prodhojnë është shumë i madh. Shembull konkret janë dy stacionet e Tiranës, ku nga vëzhgimi në terren i grupit të auditimit i shoqëruar dhe i pohuar edhe nga specialistët e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e ajrit, u pa, se të dhënat shënonin 25-30 µg/m<sup>3</sup>, ndërkohë që vlerat reale (që prodhoheshin nga tubat pasive me të cilat bëhej dhe krahasimi) ishin 3 herë më të larta. Norma e vendit tonë sa i përket PM<sub>10</sub> është 40 µg/m<sup>3</sup>. Në metodologjinë e monitorimit të cilësisë së ajrit ka 2 lloje matjesh, matjet fikse dhe matjet treguese. Matje fikse janë ato matje që kryhen në territore të caktuara vazhdimisht (365 ditë/vit ose 90 % e kësaj sasi për ndotës të veçantë), ndërkohë që matjet treguese, janë matje që plotësojnë objektivat e cilësisë së të dhënave që janë më pak të sakta se ato që kërkohen për matjet fikse. Shpesh herë, media, ekspertë apo edhe politikanë i janë referuar matjeve treguese duke prezantuar të dhëna që kanë dalë nga një fushatë 2-3 javore monitorimi të cilësisë së ajrit si vlera reale të qyteteve. Kjo gjë ka patur synim vetëm keqinformimin e qytetarëve në lidhje me gjendjen e cilësisë së ajrit. Nuk mundet që një periudhë vetëm disa javore të jetë prezantuese e vlerave të elementëve ose treguesve kryesorë të cilësisë së ajrit të cilat kanë norma vjetore si dhe kanë metodologji apo periudha më të gjata kohore se sa disa javore për të arritur në mesataren vjetore.

Në qytetin e Tiranës për vitin 2014 dhe 2015 për të gjetur mesataren e cilësisë së ajrit urban është vepruar duke matur në 2 pika të ndryshme monitorimi për periudha disa javore me stacione të lëvizshme. **Kjo, nuk mund të jetë aspak vlera reale e qytetit të Tiranës.** Sot, në Tiranë janë vetëm 2 stacione fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në administrim të ISHP-së, që ndodhen respektivisht në qendër të Tiranës dhe pranë Parkut Kombëtar të Dajtit (prapa Institutit të Shëndetit Publik - ISHP). Në një kohë kur Tirana ka vetëm 2 stacione fikse të monitorimit të ajrit, çdo ekspert, specialist apo njohës i mirë i çështjeve të mjedisit e kupton që vendosja e stacionit të monitorimit të ajrit prapa ISHP-së është e padobishme. Në të gjithë territorin e vendit tonë kemi vetëm **7 stacione të matjeve fikse** të cilët monitorojnë pa ndërprerje nga të cilat 2 për një periudhë 2 vjeçare (2015-2016) nuk kanë qenë në gjendje pune. Numri i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse. Për të qenë sa më realist, nga një krahasim që grupi i auditimit ka bërë me vendet e rajonit, Shqipëria rezulton të jetë vendi me numrin më të vogël të stacioneve edhe pse shtete si Kosova (**12 stacione fikse** të monitorimit të cilësisë së ajrit) e Maqedonia (**17 stacione fikse** të monitorimit të ajrit) kanë një sipërfaqe më të vogël se ne. Monitorimi i ajrit në Shqipëri i ngjason një të sëmuri i cili nuk ka një termometër të saktë për të kuptuar nivelin e temperaturës.

Nga ana tjetër Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve i cili ka përgjegjësinë që të ndëshkojë ndotësit e mjedisit në tërësi dhe po ashtu të ajrit nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit, sepse nuk zotëron asnjë mjet/laborator për matjen e këtyre shkarkimeve në terren për rrjedhojë edhe marrja e masave administrative është subjektive dhe në rastin konkret mund të krahasohet me një polic rrugor i cili vendos një gjobë për tejkalim shpejtësie pa patur radarin si mjet të vërtetimit të tejkalimit të shpejtësisë. Kundravajtjet administrative, veprat penale kundra ndotjes së ajrit, ligji për ndotjen e ajrit dhe ligji i inspektimit nuk janë të koordinuara duke qenë se nuk bëjnë dallim midis veprave penale

dhe atyre administrative. Qytetarët e vendit tonë nuk informohen në kohë reale lidhur me vlerat e cilësisë së ajrit dhe nuk kanë akses “on line” për t’u informuar se sa është niveli i ndotjes në qytetin ku ata banojnë. Ky akses është i garantuar vetëm për specialistët e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ajrit. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, janë edhe sëmundjet që lidhen direkt ose indirekt me cilësinë e ajrit të jashtëm. Instituti i Shëndetit Publik nuk ka të dhëna konkrete se sa ka ndikuar cilësia e ajrit në shtimin e numrit të vdekjeve, shtimin e sëmundshmërisë së popullsisë veçanërisht në zona të ndotura. Raporti i OBSH-së për vitin 2012, në rubrikën përkatëse për Shqipërinë ka përcaktuar tregues të ndryshëm si për shembull numrin e vdekjeve ose vitet e humbura të jetës si pasojë e ndotjes së ajrit, por askush në Shqipëri nuk mund të thotë se si kanë dalë këto rezultate, as ISHP që e ka detyrim të raportojë pranë OBSH-së dhe as selia e saj në Shqipëri.

## **Financimi i sistemit shëndetësor nën optikën e një auditimi performance të KLSH-së**

nga Alfred Leskaj- Kryeauditues, KLSH  
botuar në gazetën “Telegraf”, më 15 shkurt 2018.

Kujdesi shëndetësor është një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të vendit. Një popullatë e shëndetshme, është parakushti i një shoqërie që funksionon e zhvillohet në mënyrë harmonike. Por prej vitesh perceptimi i qytetarëve shqiptarë është që cilësia e shërbimeve shëndetësore është e ulët. Kjo ndjesi e përgjithshme ka ndikuar në pakënaqësinë e tyre ndaj këtyre shërbimeve, të ofruara kryesisht nga institucionet shëndetësore publike.

Shëndetësia shqiptare ka pasur dhe ka një numër jo të vogël sfidash, të cilat prekin drejtpërdrejt standardin dhe nivelin e produkteve që ajo ofron për pacientët. Procedurat e zgjatura dhe me shumë hallka në sistemin e referimit për pacientët, pakënaqësia e pacientëve për cilësinë e dobët të shërbimeve shëndetësore, financimi i ulët i sistemit shëndetësor, rritja e kostove të shërbimeve në mungesë të protokolleve të miratuara, etj., përbëjnë problemet kryesore dhe tregojnë performancën e ulët të sistemit shëndetësor.

KLSH në përfundim të auditimit të performancës mbi kostimin e shërbimeve spitalore, në raportin përfundimtar të auditimit të miratuar me Vendimin e Nr. 204 datë 29/12/2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka evidentuar parregullsi dhe problematika të ndryshme në sistemin e ofrimit të kujdesit shëndetësor. Në mënyrë të përmbledhur ato kanë qenë pjesë e konstatimeve dhe rekomandimeve për Ministrin e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, Fondin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor dhe spitalet universitare dhe rajonale në vend duke evidentuar probleme, mes të cilave, domosdoshmërinë mbi;

- a) Hartimin dhe miratimin e Protokolleve Klinike, sipas praktikave më të mira.
- b) Implementimin e modelit DRG.
- c) Rritjen e autonomisë së spitaleve
- d) Rritjen e transparencës së shpenzimeve.
- e) Optimizimin e përdorimit të burimeve të ndryshme.
- f) Zhvillimin dhe shtrirjen e projektit *e-health* mbi shëndetësinë elektronike.
- g) Zvogëlimin e procedurave të panevojshme dhe të shumëfishta për përfitimin e kujdesit shëndetësor, etj.

Gjatë këtij auditimi nga departamenti i performancës së KLSH janë adresuar përgjegjësitë dhe rekomandime të ndryshme të cilat, të vlerësuara drejt, potencialisht mund të sjellin përmirësime në të ardhmen nga institucionet e kujdesit shëndetësor.

Sistemi aktual shëndetësor përdor protokolle dhe udhërrëfyes klinikë, mbi bazën e klasifikimit ICD9-CM, një standard i kufizuar deri në 300 sëmundje. Shumica e vendeve të tjera e përdorin në mënyrë standarde klasifikimin ICD-10. Megjithatë Ministria e Shëndetësisë ka hartuar disa protokolle dhe udhërrëfyes klinikë, ato kanë nevojë të rinovohen, pasi kanë një kohë të gjatë që janë hartuar dhe nuk i përgjigjen zhvillimeve të fundit të shëndetësisë. Vlen të theksohet, për shembull, se në QSUT vetëm një shërbim përdor protokolle të miratuara nga MSHMS sipas praktikave të mira, duke u bazuar në klasifikim më të fundit ICD-10. Ekzistenca e protokolleve dhe udhëzuesve klinikë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë do të ketë për pasojë zvogëlimin e keqpërdorimit dhe abuzimit të barnave dhe materialeve mjekësore, si dhe në evidentimin e përgjegjësive të stafit mjekësor për trajtimin e pacientëve.

Sa i përket financimit të shërbimit shëndetësor përfshijnë përdorimin e sistemit DRG – (Diagnosis Related Grouping - Grupimit në bazë të Diagnozës) për përcaktimin e kostove të shërbimeve spitalore.

Kostimi i shërbimit shëndetësor në rrjetin tonë spitalor publik, evidenton këto nevoja primare:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me FSDKSH, QKCSA-ISH dhe QSUT kërkohet të hartojë/rinovojë Protokollin dhe udhëzuesit klinikë për institucionet shëndetësore.

2. Financimi i shërbimeve spitalore duhet të bëhet mbi bazën e përcaktimit të kostove sipas modelit DRG, klasifikimit më të fundit ndërkombëtar ICD-10 të sëmundjeve dhe protokolleve/udhëzuesve klinikë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Institucionet shëndetësore duhet të garantojnë cilësinë e shërbimeve shëndetësore sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet procesit të akreditimit.

4. FSDKSH duhet të aplikojë procedurën e prokurimeve publike për përfituesit e institucioneve shëndetësore jo publik për paketat shëndetësore që ajo financon.

5. Institucionet publike përgjegjëse për kontrollin e paketave shëndetësore duhet të realizojnë vlerësimin cilësor të tyre sipas parametrave klinikë të përcaktuara në protokollin klinikë.

6. Përcaktimi i marzhit të fitimit për paketat shëndetësore nga Këshilli Teknik i FSDKSH të bëhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

7. Rritja e shkallës së autonomisë për spitalet dhe ndryshimi i formës së menaxhimit të tyre për t'ju përshtatur ndryshimeve të parashikuara në ligjin e sigurimeve të kujdesit shëndetësor dhe zhvillimeve të shëndetësisë.

8. Sistemet informatike pjesë e shëndetësisë elektronike përveç avantazheve në aspektin klinik, të ndikojnë në rritjen e transparencës, zvogëlimin e korrupsionit, zvogëlimin e barrës administrative, zvogëlimin e kostove shtesë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

9. FSDKSH duhet të planifikojë një sistem informatik të unifikuar për vlerësimin e kostove spitalore për të reflektuar zhvillimet e fundit të shëndetësisë dhe mundësinë e suportimit të Protokolleve Klinikë sipas klasifikimit ICD-10 dhe modelit DRG.

10. Sistemet informatike të FSDKSH, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Institucioneve Shëndetësore duhet të jenë të unifikuar në gjenerimin e raporteve sipas formatit të kërkuar të regjistrimit elektronik dhe kërkesave të blerësit unik të shërbimeve FSDKSH. Këto konkluzione, fryt i një analize të kujdesshme dhe të thelluar, të grupit të auditimit të departamentit të performancës së KLSH, shpiten në disa konkluzione të rëndësishme. Ndër më kryesoret përmendim:

Sistemi aktual i vlerësimit të kostove për shërbimet spitalore është një vlerësim që mbart shpenzime të tepërta dhe nuk reflekton kostot e vërteta, duke orientuar kërkesat e institucioneve

shëndetësore spitalore drejt vlerësimit të shpenzimeve dhe jo sipas kostove të tyre. Mungesa e specialiteteve pranë shërbimeve në spitalet rajonale dhe bashkiake, si dhe mungesa e performancës së shërbimit parësor ka krijuar rritjen e kostove dhe përqendrimin e pacienteve në qendrën më të madhe universitare QSUT. Implementimi i paketave shëndetësore përbën një nismë të mirë për miratimin e protokolleve për këto paketa, por mënyra e vlerësimit financiar të tyre bie ndesh me ligjin e prokurimeve publike, duke rritur kostot e këtyre shërbimeve shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Fondin edhe QSUT duhet të angazhohen në hartimin dhe implementimin e protokolleve klinike për të gjitha shërbimet spitalore duke pasur si orientim modelin DRG dhe klasifikimin më të fundit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10. Riorganizimi i hartës së spitaleve mbi bazën e treguesve të performancës së shërbimit spitalor përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për uljen e kostove të tepërta për sistemin shëndetësor. Premisat e krijimit të një tregu shëndetësor do të çonte në ekuilibrin e kërkesë-ofertës duke rritur eficiencën, cilësinë e shërbimeve nga ofruesit e kujdesit shëndetësor për pacientë.

## **Energjia e qëndrueshme, objekt i kontrollit të një SAI**

nga Megi Rusi- Audituese , KLSH

botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 24 shkurt 2018.

Çështja e energjisë së rinovueshme e të qëndrueshme është mjaft delikate dhe komplekse e fatkeqësisht edhe pse është në qendër të vëmendjes së politikave kombëtare e ndërkombëtare, ajo është fare pak e trajtuar nga këndvështrimi i auditimit. Burimet e energjisë së rinovueshme përfshijnë energjinë e ujit, erës, ajrit, diellit, biomasës, mbetjeve, atë gjeotermale, etj. Pëcaktimet dhe kufizimet në lidhje me burimet e energjisë së rinovueshme ndryshojnë nga vendi në vend, dhe secili prej tyre ka politikën e tij lidhur me llojet e burimeve të energjisë që do të shfrytëzohet. Në Shqipëri burimi më i përhapuri kësaj energjie është padyshim uji, dhe shumë pak dielli apo era.

Shqipëria, ka një shpërndarje hidrografike me një sipërfaqe ujëmbledhëse të madhe e cila është rreth 57% më shumë se gjithë territori shtetëror i vendit, duke bërë që hidroenergjinë të jetë burimi më i përhapur i energjisë së rinovueshme. Sot në vendin tonë mbi 98% e energjisë elektrike sigurohet nga energjia hidrike, ndërkohë që burimet e tjera kanë një rol dytësor në kontributin e tyre.

Energjia e ujit mund të përftohet në mënyra të ndryshme, duke shfrytëzuar rrjedhën e ujit, presionin e tij ose një kombinim të të dyjave, që është tipik për hidrocentralet me diga. Energjia potenciale gjenerohet si rezultat i gravitetit dhe varet nga diferenca e niveleve të lartësive. Aktualisht në vendin tonë janë ndërtuar e po vazhdojnë të ndërtohen një sërë hidrocentralesh me kapacitet të madh e të vogël, në rrjedha të ndryshme ujore të shpërndara gjeografikisht në gjithë territorin e Shqipërisë. Një nga avantazhet e energjisë së ujit është ndotja minimale e mjedisit e krahasuar me forma të tjera të prodhimit të energjisë. Hidrocentralet përgjithësisht kërkojnë një mirëmbajtje minimale dhe mund të operohen nga distanca. Ato mund të vihen në veprim brenda pak sekondave dhe për këtë arsye mund të përdoren për të mbuluar kërkesat e menjëhershme të prodhimit të energjisë, sidomos në kohën e pikut të saj. Edhe pse energjia e ujit renditet ndër më të përdorurat, ajo gjithashtu ka disa të meta. Hidrocentralet karakterizohen nga kosto të larta të investimeve, veçanërisht në rastin e hidrocentraleve të mëdha dhe kjo shkon krahas me ndikimet negative në mjedis siç është nevoja për të përmbytur sipërfaqe të mëdha toke, shkatërrimi i biodiversitetit dhe efektet e ndryshme socialo-ekonomike. Sasia e energjisë së



prodhuar gjithashtu mund të varet nga luhatjet e nivelit të rrjedhjes së ujit, kësisoj furnizimi mund të mos jetë gjithmonë i vazhdueshëm.

Auditimet e përqendruara në fushën e energjisë së qëndrueshme përgjithësisht janë auditimet mjedisore për çështje specifike, por jo domosdoshmërisht. Ato mund të përfshijnë të gjitha llojet e auditimeve, në varësi të kushteve konkrete të hasura dhe mund të shtrihen në faza dhe hallka të ndryshme të ciklit si në burim ashtu edhe gjatë gjenerimit, furnizimit apo konsumimit të energjisë. Duke marrë parasysh investimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm të këtij sektori, ka ardhur koha që Kontrolli i Lartë i Shtetit të drejtoj fokusin e tij edhe në auditimet e infrastrukturës së energjisë së rinovueshme. Kjo është një iniciative e madhe sepse në shumë vende të botës ende nuk ka pasur përvojë të mjaftueshme me auditimet e kryera në mënyrë specifike në fushën e energjisë së qëndrueshme. Fenomeni i vërtetuar nga studimet e pyetësorët të kryer në 60 Institucione të ndryshme Supreme të Auditimit (SAI) në botë ku vetëm ¼ e tyre kanë raportuar se kanë eksperiencë në auditime në fushën e prodhimit të energjisë dhe kursimit të sajë të gjeneruar nga burime të rinovueshme ose jo të rinovueshme, çka dëshmon për eksperiencën e pakët të hasur në këtë fushë auditimi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithashtu ka kryer auditime në institucione mjedisore si ish Drejtoritë e Pyjeve, Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ku ka identifikuar problematika të ndryshme në lidhje me pasojat dhe ndikimet në mjedis nga ndërtimi i hidrocentraleve, si dhe ka lënë rekomandime për marrjen e masave të rrepta për zvogëlimin e risqeve në aspektin e mbrojtjes së mjedisit duke rritur përgjegjshmërinë e institucioneve në lidhje me lejet mjedisore dhe kontrollin e zbatimit korrekt të tyre. Rëndësia e ekzistencës dhe ruajtjes së mjedisit apo zonave të mbrojtura në thelb ka të bëjë me gjenerimin e përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore, përfitime të cilat kanë rezultuar shumë të vakëta për periudhat e auditimit, për shkak të kohës së shkurtër të ekzistencës së institucioneve përkatëse si dhe mungesës së një mbështetjeje institucionale nga strukturat më të larta. Këto problematika të hasura shërbejnë si indicie dhe për programimin e auditimeve specifike të infrastrukturës së energjisë së rinovueshme së bashku me politikat shtetërore të mirë studiara dhe zbatimin real të tyre.

Për më tepër Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitet e fundit ka bërë një sërë përpjekjesh për të ngritur kapacitetet e stafit në këtë drejtim duke mundësuar trajnime ndërkombëtare në fushën e auditimit të infrastrukturës së qëndrueshme, si qëndrueshmëria e infrastrukturës së ujit, transportit, materialeve të ndërtimit, minierave dhe padyshim energjisë së rinovueshme.

Procedura e përgatitjes së auditimit specifik në këtë fushë gjen zbatueshmëri edhe duke u bazuar në udhëzimet e auditimit të INTOSAI, ku përfshihen *ISSAI 5130 Zhvillimi i Qëndrueshëm "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Manuali i Auditimit të Energjisë së Qëndrueshme për Institucionet Supreme të Auditimit etj*, udhëzime ku paraqiten rekomandime të përgjithshme dhe ndihmëse për kryerjen e auditimeve të përqendruara në këtë fushë, si dhe informacion i dobishëm për çështjet e energjisë. Këto dokumenta kanë si qëllim të asistojnë audituesit gjatë përgatitjes së auditimeve në fushën e energjisë së qëndrueshme duke ofruar shëmbuj për mënyrën se si duhet të përcaktohen kriteret dhe qasjet e auditimit.

Institucioni i auditimit mund të zhvillojë analizën e vet të riskut për të verifikuar vlefshmërinë e temave të mundshme të auditimit. Kjo analizë zakonisht është pjesë e një studimi paraprak të një procedure auditimi e cila është paralelisht pjesë e fazës së planifikimit. Zgjedhja e një teme të përshtatshme të auditimit është vendim i institucionit auditues i cili e referon planifikimin për auditim bazuar në vlerësimin e situatës në fushën e energjisë së qëndrueshme, verifikimit se si

kjo fushë është e rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare dhe me ligjet kombëtare, si dhe bazuar në pasqyrën e instrumenteve të qeverisë për menaxhimin e energjisë, duke përcaktuar në këtë mënyrë fushën për auditim në hallkat e dobëta të këtij zinxhiri që kanë ndikim negativ. Zhvillimi i qëndrueshëm nxjerr në pah nevojën për ekuilibrin mes aspekteve ekonomike, sociale dhe mjedisore. Prandaj, qëndrueshmëria nuk është e njëjta gjë me ndikimin në mjedis, por një koncept më kompleks. Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon një përpjekje nga të gjithë sektorët, dhe për të kontrolluar ndikimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në përgjithësi dhe asaj të energjisë në veçanti, audituesi duhet të përqendrohet në çështjet mjedisore duke i kushtuar vëmendje aspekteve sociale dhe ekonomike.

## **Qasja e KLSH në rritjen e kapaciteteve njerëzore, nëpërmjet përhapjes së dijes**

*nga Brunilda Zeneli- Kryeaudituese, KLSH  
botuar në gazetën “Sot”, më 24 shkurt 2018*

*“Dituria është si paraja: për të pasur vlerë duhet qarkulluar dhe në qarkullim mund të rritet në sasi dhe me shpresë edhe në cilësi”. Louis L’Amour.<sup>3</sup>*

E citova këtë thënie të shkrimtarit amerikan Louis L’Amour, për të treguar rëndësinë që dija, si një proces që e shoqëron individin gjatë gjithë jetës, si dhe përçimi i saj tek të tjerët, ka për individin dhe mjedisin ku punojmë dhe jetojmë.

KLSH, synon të jetë një institucion profesional i besueshëm që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e te enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit. Për të arritur këtë KLSH nuk mund të kufizohet vetëm në raportimin e përdorimit të parave publike në përputhje me ligjin, por duke qenë një trupë profesionale dhe me një gjykim prej eksperti. Misioni i saj shtrihet edhe tek vlerësimi i përgjegjshmërisë qeveritare dhe të enteve të tjera publike në lidhje me përdorimin e burimeve publike në tërësi.

Pikërisht, nisur nga fakti i këtij misioni të rëndësishëm, por dhe të vështirë që ka, KLSH i ka kushtuar një vend të rëndësishëm në të gjithë planet e saj strategjike shtimit dhe forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore. KLSH në planin e saj strategjik ka si bosht të filozofisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, vlerësimin e tyre si një aset institucional, duke u fokusuar në konsolidimin dhe trajnimin e tyre të vazhdueshëm me qëllim rritjen e dijes individuale dhe kolektive dhe përçimin e saj tek të tjerët.

Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, KLSH gjatë viteve 2012-2017 e ka patur në fokusin e saj kryesor. Rritja e kapaciteteve profesionale, ju krijon mundësi audituesve të ndjekin ritmet e ndryshimeve, duke e bërë KLSH më dinamike dhe pjesëmarrëse.

---

<sup>3</sup> Poet dhe shkrimtar amerikan. Në 1982 ai mori Medaljen e Artë të Kongresit, dhe në vitin 1984. Presidenti Ronald Reagan i dha L’Amour Medaljen Presidenciale të Lirisë.

Nisur nga sa thamë më lart, KLSH këtë sfidë e ka përmbushur më së miri gjatë viteve 2002-2017, duke u angazhuar në një punë të pandërprerë për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, gjë e cila është realizuar nëpërmjet disa mënyrave të cilat njihen edhe si praktikatat më efikase për përhapjen e dijes, e konkretisht:

*a. Npërmjet rotacionit brenda institucionit:*

Npërmjet rotacionit, ku transferimi i dijes nga njëri pozicion në tjetrin ndihmon për rritjen e kapaciteteve profesionale. Pikërisht për të shfrytëzuar pozitivisht dijen dhe për ta transferuar atë tek të tjerët, nga Kryetari i KLSH-së është ndjekur një politikë e tillë, ku auditues me eksperience dhe aftësi profesionale të spikatura, por edhe auditues të rinj janë promovuar në pozicione të ndryshme. Kjo traditë ka ndjekur vazhdimësinë e saj dhe është aplikuar dhe së fundmi, ku Kryetari i KLSH-së theksoi domosdoshmërinë e saj në Analizën vjetore të KLSH-së 2017.

Rotacioni është aplikuar në të gjitha nivelet, në nivelin e audituesve, të kryeaudituesve, si dhe të drejtorëve ku janë përfshirë të gjithë departamentet si Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Departamenti i Auditimit të Performancës, Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, Departamenti i Auditimit të Investimeve të Huaja dhe Teknologjisë së Informacionit, etj. Ky rotacion i vazhdueshëm, i shtrirë në të gjitha nivelet strukturore, ka shërbyer më së miri për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit në disa fusha, si dhe për shkëmbimin e dijes.

*b. Npërmjet shkëmbimit të dijes me organizata jashtë institucionit:*

Npërmjet shkëmbimit të dijes midis institucioneve dhe organizatave të fushës, me njerëz që kanë role të ndryshme, ka rezultuar një prej mënyrave më efektive për rritjen e dijes individuale dhe kolektive. Pikërisht KLSH, gjatë periudhës 2012-2017, ka institucionalizuar 9 marrëveshje bashkëpunimi me SAI homologe dhe konkretisht të: Austrisë, Turqisë, Polonisë, Sllovenisë, Kosovës, Kroacisë, Malit të zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë. Këto Marrëveshje Bashkëpunimi, kanë shërbyer si një aset mjaft produktiv me impakt rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të KLSH-së. Gjithashtu, jo më pak të rëndësishme kanë qenë një sërë bashkëpunimesh me organizata ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI, ku KLSH është anëtare e Grupit të Punës së INTOSAI për auditimin e integritetit në subjektet e audituara dhe do të angazhohet në të ardhmen në realizimin dhe shtimin e numrit të auditimeve të integritetit, EUROSAI, SIGMA, DG-Budget ku vlen për t'u theksuar partneriteti i vendosur mes KLSH dhe DG-Budget. Një rol të rëndësishëm ka patur dhe ka bashkëpunimi me institucionet e vendeve më të përparuara në fushën e auditimit si Government Accountability Office (GAO)-Amerikë, European Court of Auditors (ECA)-BE etj., ku janë zhvilluar një sërë trajnimesh, konferencash, pjesëmarrje në auditime, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në cilësinë e veprimtarisë audituese të KLSH, ku shkëmbimi i dijes dhe eksperiencave ka qenë vendimtar në rezultatet e përfutuara.


*c. Npërmjet trajnimit të vazhdueshëm:*

Të mësuarit dhe dituria janë të ndërlidhura së bashku. Strategjitë e dijes rrethojnë iniciativat e të mësuarit dhe dijes, ato duhet të konvergjojnë me iniciativa trajnimi. Trajnimi si koncept në përgjithësi është i domosdoshëm të zhvillohet në të gjitha organizatat publike apo private, pasi ka ndikime të drejtpërdrejta në cilësinë dhe rezultatet e punës së çdo njësie organizative. Por një rëndësi të veçantë trajnimi i burimeve njerëzore ka në KLSH, si një organizatë e cila nëpërmjet auditimeve, do të vlerësojë përgjegjshmërinë qeveritare dhe të enteve të tjera publike në lidhje

me përdorimin e burimeve publike në tërësi, programet qeveritare dhe të enteve të tjera publike në lidhje me transparencën dhe sa e si rezultatet e këtyre programeve kanë kënaqur interesat e taksapaguesve shqiptare, angazhohet të vlerësojë edhe veprimtarinë e administratorëve publikë në lidhje me përmbushjen e përgjegjësiave të tyre për përdorimin e parave publike dhe kjo kërkon individë të ditur. Nëpërmjet trajnimit individët e veçantë përfitojnë njohuri shtesë, me qëllim që të bëhen më të aftë profesionalisht dhe në këtë mënyrë të kuptojnë dhe të zgjidhin në një kohë më të shkurtër e me cilësi objektivat e tyre individuale, si dhe objektivat e organizatës në tërësi. Vetëm me rekrutimin e suksesshëm të punonjësve, KLSH nuk mund të arrijë objektivat e veta, çdo gjë është në lëvizje dhe ndryshim të pandërprerë, prandaj dy prej nën objektivave të strategjikë, janë rritja e kapaciteteve njerëzore institucionale dhe rritja e kapaciteteve njerëzore individuale, pasi nëpërmjet tyre arrihet:

- Përfitimi punonjësve të kualifikuar dhe të vlefshëm;
- Rritja cilësisë së punës audituese;
- Rritja e besueshmërisë ndaj KLSH-së;

Në zbatim të rekomandimeve të Kongresit të INTOSAI, 2010 dhe e rishikimeve të bërë nga vijimësi nga kjo organizatë, KLSH ka implementuar në Matjen e Performancës Institucionale sipas Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-ve, ku rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit, janë pjesë e saj. Në funksion të kësaj metodologjie janë monitoruar parametrat e zhvillimit institucional duke vlerësuar kapacitetet audituese dhe cilësinë në auditim. Praktikrat e mira të fushës, kërkojnë që zhvillimi metodologjik dhe profesional i burimeve njerëzore, të kryhet bazuar në dy shtylla kryesore, ku njëra prej tyre është *trajnimi i vazhdueshëm i stafit auditues*. KLSH ka forcuar kapacitetet audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshtimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Për arritjen e këtij objekti strategjik dhe të vazhdueshëm të KLS-së, faktet flasin vetë.



Rëndësia e procesit të trajnimit është cekur jo pak herë edhe nga studiues të huaj, të cilët e kanë cilësuar trainimin si:

○ **“Procesi i trajnimit është procesi i përvetësimit sistematik të sjelljeve, koncepteve, njohurive, roleve apo aftësive që sjellin një performancë më të mirë në punë”.**

## **Auditimi i KLSH, për një reflektim realist shtetëror për bashkimin doganor Shqipëri-Kosovë**

nga Sali Agaj dhe Redi Ametllari –Auditues, KLSH  
botuar në gazetat “Telegraf”, “55”, “Koha Jonë”, më 27 shkurt 2018

Në mbyllje të vitit 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit përfundoi auditimin e performancës me temë “Unifikimi i pikave doganore të Shqipërisë me Kosovës”, miratuar me Vendimin e Kryetarit Nr.202, datë 29.12.2017. Auditimi kishte si risi bashkëpunimin e frytshëm me institucione të rëndësishme të Kosovës si, Zyra Kombëtare e Auditimit, Ministria e Financave, Dogana dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Raporti përfundimtar i auditimit iu përcoll Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kuvendit, Kryeministrit, Ministrisë së Diasporës dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ambasadës së Kosovës.

Natyrshëm, pritshmëria dhe ndjeshmëria e publikut dhe biznesit janë të larta. Në aspektin politik të integriteteve, e si financuese e pikës së përbashkët doganore në Morinë-Vermicë, Bashkimi Europian është një tjetër aktor që ka një pritshmëri të lartë për të parë tek Shqipëria një ekonomi të fortë, me protagonizëm rajonal, si dhe institucionalisht të pjekur për t’u bashkuar në familjen europiane. Për shkak të valencave të shumta që mbart tema, u trajtuan studime ekonomike nga Universiteti i Harvardit, hulumtime nga ekspertë të makroekonomisë dhe anketa për biznesin, të hartuara nga grupi i auditimit, veçanërisht me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë të Tiranës dhe Odën Ekonomike të Kosovës, për të zërthyer në një masë të gjerë komponentët e këtij auditimi. Në përfundim të punës audituese, KLSH ka arritur në mesazhin se: *“Me gjithë përparimin e arritur në fushën e shkëmbimit tregtar dhe bashkëpunimit doganor, marrëveshjet e nënshkruara nuk përbëjnë një bazë të plotë rregullatore për unifikimin doganor me Kosovën. Marrëveshjet e nënshkruara karakterizohen nga një formë e shprehjes së vullnetit të mirë, por nuk janë pasqyruar në politika të mirëfillta qeveritare, të cilat do ta realizonin me përgjegjshmëri dhe me sukses bashkimin doganor me Kosovën. Konstatohet se nuk ka një angazhim të vazhdueshëm institucional, bazuar në një strategji të posaçme për unifikimin doganor me Kosovën, gjë e cila ka dëmtuar dukshëm besimin e bizneseve në dy anët kufirit. Veprimtaria e Ministrisë së Financave e Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave në unifikimin e pikave doganore është e mangët dhe nuk ka krijuar premisat për një bashkim doganor të shpejtë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Nuk është hedhur hapi vendimtar, unifikimi i politikave fiskale, si parakusht për sigurimin e bashkimit doganor, i cili përbën një potencial për rritjen e shkëmbimit të mallrave, rritjen e ekonomisë për dy vendet, si dhe një parapërgatitje e proces maturimi për institucionet shqiptare për t’u bërë ballë sfidave që parashtron integrimi në tregun europian”.*

**Pozicioni i Shqipërisë dhe Kosovës në CEFTA:** Shqipëria me Kosovën kanë lidhur një marrëveshje të tregtisë së lirë (MTL), por bashkimi doganor është një shkallë më e lartë, jo vetëm si ndërveprim ekonomik, por edhe si një sinkronizim ekonomiko-fiskal dhe kërkon vendosjen e tarifave të përbashkëta karshi vendeve të treta. Në rastin e MTL-së, siç është CEFTA, shtetet anëtare tregtojnë pa tarifa doganore me njëri tjetrin, por ruajnë sovranitetin e politikave tregtare me shtetet e tjera jashtë CEFTA-s. Pra, tarifatat e vendosura karshi atyre vendeve jo anëtare ndryshojnë nga një shtet në tjetër. Kjo mund të çojë në fenomenin që në teorinë ekonomike quhet “diversion tregtar” (Viner 1950) – një situatë ku të mirat nga jashtë MTL importohen në një vend anëtar me tarifë të ulët, nga ku mund të dërgohen pa tarifë në një vend brenda MTL-së që aplikon një tarifë të lartë për palët e treta. Bazuar në të dhënat e INSTAT, në periudhën 2012-2016 eksportet me vendet e BE kanë zënë mesatarisht 76,6 % të

totalit; ndërsa eksportet me CEFTA-n zënë 12,4 % të totalit. Në CEFTA, megjithë barrierat e shumta burokratike që ngrihen nga vendet anëtare karshi mallrave shqiptare, Shqipëria ka raportuar vetëm 3 raste (numrin më të vogël krahasuar me shtetet e tjera) në Komitetin e Përbashkët gjatë periudhës 2009-2016. Kjo tregon një nivel të dobët të komunikimit dhe aksesit që ka biznesi shqiptar tek instancat shtetërore për të adresuar problematikat që ndesh në kufijtë ballkanikë.

**Tarfia e përbashkët:** Ekonomisti i shquar, David Ricardo, në veprën e tij “Parimet e Politikave Ekonomike dhe Taksimit” (v. 1817) thekson se “*Eliminimi i tarifave do të sillte një përfitim neto në dobi të mirëqenies së përgjithshme – nga ku përfitimet e konsumatorëve janë më të mëdha se humbjet e prodhuesve*”. Vendosja e tarifave të përbashkëta është një proces i shtrirë në kohë, p.sh BE-së iu deshën 11 vjet dhe me efekte zinxhir në hallkat ekonomike dhe administrativ. Sipas një skenari 1, vendosja e një tarifë të përbashkët sjell një tarifë të lartë përshebull për Kosovën. Kjo nënkupton që konsumatorët në Kosovë do të paguajnë çmime më të larta për importet nga jashtë unionit doganor ose do të furnizohet nga furnitorë më pak eficient nga Shqipëria. Pavarësisht tarifave të larta të importit, qeveria e Kosovës do të përfitojë më pak të ardhura për shkak të alternimit të burimit të importit, nga vendet me jashtë, me furnitorë nga Shqipëria. Sipas një Skenari 2, vendosja e një tarife më të ulët, përshebull në Shqipëri, do të ulte riskun e diversionit tregtar dhe do të sillte dy efekte pozitive. Së pari do të rriste importet e Shqipërisë nga vendet e tjera duke sjellë efektin pozitiv të “krijimit të tregtisë”. Së dyti, do të rriste të ardhurat ne importet. Prodhuesit vendas, megjithëse do të ndeshen me një konkurrencë të lartë, kjo do të kompensohej nga përfitimet që do të vijnë për konsumatorët, të cilët do të blejnë mallra me çmime më të ulëta. Rregullimet ligjore: Cili shtet do t’i mbledhë detyrimet doganore? Si do të mblidhen këto detyrime dhe si do të bëhet ndarja e të ardhurave?

**Barrierat burokratike:** Për periudhën, 2012-2016 eksportet me Italinë zinin mesatarisht 51,0 % të eksporteve gjithsejt të Shqipërisë, ndjekur nga Kosova me 7,5 %, Spanja me 6,8 %, Greqia me 3,9 %. Eliminimi i barrierave jotarifore përbën qëllimin kryesor të Marrëveshjes për Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë kuadër janë ngritur edhe grupe pune, por biznesi vazhdon të ndeshet me tilla pengesa. Sipas një ankete të kryer nga Oda Ekonomike e Kosovës, theksohet se “Ekzistimi i barrierave jo-tarifore, në të vërtet paraqet një neglizhencë të qeverive respektive. Andaj duhen siguruar kushte që incidentet e shpeshta që paraqiten në sektorë të ndryshëm të mos ndodhin, duke krijuar kështu kushte për fuqizimin e marrëdhënieve tregtare”. Tre janë format kryesore të barrierave të hasura nga biznesi i Kosovës: Burokracia e tepruar; Certifikata e origjinës; Dokumenti fitosanitar dhe më konkretisht: Në pikën kufitare shqiptare kërkojnë noterizimin e analizave të kualitetit të lëshuara nga IKSHP ose Instituti Bujqësor dhe nuk e njohin dokumentin fitosanitar. Sipas bizneseve kosovare të anketuar, Shqipëria është i vetmi vend që kërkon dokumente të ndryshme, madje edhe krahasuar me të gjitha shtetet e BE-së, etj.

**Operimi i Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit:** Në Portin e Durrësit, 90% e tranzitit dhe 30 % e mallrave që përpunohen kanë si destinacion Kosovën. Deklaratat publike në këtë rrafsh, të cilat shërbyen edhe si informacion për grupin e auditimit, nuk përputheshin me gjendjen reale të konstatuar nga grupi auditues në fushën e ekzistencës së bazës ligjore, përgatitjeve administrative nga Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe kapaciteteve infrastrukturore të Portit të Durrësit. Nga operimi i plotë i doganës kosovare në Portin e Durrësit, bizneset do të përfitonin një ulje të kostos aktuale me rreth 2 milionë euro në vit. Braktisja e projektit për vënien e Portit të Shëngjinit në shërbim të Doganës së Kosovës, pa u kryer një studim i mirëfilltë për potencialet dhe përfitimet ekonomike që do të sillte për të dy vendet, ka shkaktuar një mungesë përgatitjeje institucionale e cila është reflektuar edhe në shtyrjen e operimit të doganës së Kosovës në Portin e Durrësit. Nga informacionet e marra nga grupi i auditimit, operimi i doganës së Kosovës në Portin e Durrësit do të fillonte në dhjetor

2017, për të cilën u përgatit edhe një projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për lejimin e kryerjes së kontrolleve fizike nga zyrtarët e zyrës doganore të Kosovës në Portin e Durrësit dhe Porto Romano dhe njohjen e licencave të agjencive të përfaqësimit Doganor të Kosovës”. Por, qeveria shqiptare hoqi dorë nga miratimi i këtij projektvendimi, për një afat të pacaktuar. Kjo tërheqje konstatohet edhe nga fakti se zyra doganore e Kosovës nuk u hap në muajin dhjetor, sikurse qe parashikuar, për arsye se nga pala shqiptare nuk është marrë asnjë masë për të plotësuar kriteret bazë të operimit, siç vëren Dogana e Kosovës në “Raportin për Parakushtet e vendosjes së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit” dërguar në datën 23.10.2017 Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Çfarë nuk shkon?** Për bashkimin doganor Shqipëri-Kosovë nuk ekziston një kuadër rregullator i posaçëm që të rregullojë marrëdhëniet mes dy vendeve, por vihet re një kuadër i shpërndarë në dispozitat e morive të marrëveshjeve të nënshkruara. Këto marrëveshje e cekin në mënyrë tangjente unifikimin e pikave doganore me Kosovën por nuk përfaqësojnë në thelb, në formë dhe përmbajtje, një bazë ligjore të posaçme. Konkretisht, Marrëveshja për Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë nuk parashikon strategjinë e implementimit të punës, organet dhe ministritë përgjegjëse për të ndjekur procesin dhe nuk kanë arritur të eliminojnë barrierat burokratike. Harmonizimi fiskal, si gur-themeli i unionit doganor, nuk është konturuar si politikë qeveritare, bazuar në një marrëveshje ndër-qeveritare, por është shtruar në formë aspirate. Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, ndonëse përmendet në mënyrë tangenciale bashkëpunimi me Kosovën dhe megjithë rëndësinë që ka për vendin tonë, ky bashkëpunim nuk parashikohet në një kapitull të veçantë.

*Mungesë efektiviteti:* Strukturat institucionale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Shqiptare nuk janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme e në koordinim me institucionet e Kosovës në këtë drejtim, për shkak të mungesës së një strategjie të posaçme. Paradoksi që është krijuar është se në optikën e performancës, procesi është invers, nga inputet po shkohet tek një objektiv i vagullt e retorik, që ndryshon trajtë pas çdo deklaratave publike, e jo nga një objektiv i qartë e strategjik tek inputet. Kjo ka shkaktuar një situatë ku Dogana shqiptare por edhe Ministria e Financave po e gjejnë veten të papërgatitura dhe shumë prapa përballë deklaratave politike në këtë rrafsh.

**Çfarë kemi rekomanduar?** KLSH ka dhënë 24 rekomandime në këtë auditim, ndër kryesore janë:

- Hartimi i një strategji kombëtare të posaçme për bashkimin doganor me Kosovën, për ta veçuar Kosovën nga përgjithësimi i një bashkëpunimi ekonomik me vendet e Europës Juglindore.
- Në grupet e përbashkëta të punës midis Shqipërisë dhe Kosovës, të përfshihen edhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë e Industrisë të Shqipërisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës, si organizata që përfaqësojnë bizneset e të dy vendeve
- Hartimi i një studimi mbi vendosjen e Portit të Shëngjinit në shërbim të Doganës së Kosovës. (*Porti i Shëngjinit – Porti i integriteteve shqiptare” Fjala e deputetit Bujar Leskaj në Kuvendin e Shqipërisë, 2009*)
- MFE të marrë masa që në administratën doganore të instalohet një platformë Single Window (sikurse do të implementohet nga pala kosovare në vitin 2018) dhe të shqyrtojë rekomandimin 36 të UN/CEFCAT për të krijuar një Single Window (Dritare të Vetme) Shqipëri – Kosovë.
- MFE dhe DPD të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrativë për krijimin e një regjistri elektronik të përbashkët për bizneset që operojnë në Shqipëri dhe në Kosovë.



Këto rekomandime kanë si qëllim ndërmarrjen e hapave konkretë, për të realizuar një zhvendosje nga retorika aktuale në një angazhim shtetëror efektiv dhe gjithëpërfshirës, duke thirrur në tryezat e përbashkëta edhe organizatave të bizneseve të të djave vendeve. Po ashtu, duke marrë parasysh të metat e strukturës së eksporteve shqiptare, të cila përbëhen nga produkte me vlerë të ulët e të papërpunuara, është me rëndësi që bashkimi doganor të zhvishet nga ambalazhi politik e të parashtrohet si domosdoshmëri e realitetit të zhvillimeve ekonomike.

## **Institucione jo efektive në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore**

*nga Zija Lika*

*botuar në revistën "Monitor", më 12 shkurt 2018*

Ndonëse me vonesë kohore të konsiderueshme dy vjeçare, ish ministri i shtetit për inovacionin dhe administratën publike, në mbështetje të ligjit 152 / 2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, ka nxjerrë urdhërin nr 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil". Nëpërmjet këtij urdhëri, është përcaktuar procedura që duhet të ndiqet nga ana e institucioneve përkatëse të administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të sipërpërmendur, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës apo pozicion pune të barazvlerëshëm (të të njëjtit nivel dhe kategori), të ish nëpunësve civilë të larguar padrejtësisht nga puna, të cilët e konfirmojnë këtë të drejtë përmes këtyre vendimeve përkatëse gjyqësore.

Kjo procedurë përfshin ngritjen e një komisioni të posaçëm pranë secilit prej institucioneve përkatëse debitore, i cili duhet të shqyrtojë mundësitë e sistemimit (rikthimit) në një pozicion të rregullt pune të shërbimit civil, të ish nëpunësve gjyqfitues, zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ende të pa ekzekutuara.

Vetëm pas dërgimit nga komisioni i posaçëm tek Departamenti i Administratës Publike, të akt rekomandimit përkatës për sistemimin në punë të ish nëpunësit civil gjyqfitues, ky i fundit (DAP) duhet të vijojë me nxjerrjen e aktit të emërimit.

### **Le të shohim se çfarë ka ndodhur në DPT Tiranë**

Do të duhej të kalonin rreth 3,5 vite nga hyrja në fuqi e ligjit 152 / 2013 "Për nëpunësin civil", apo 1,5 vite nga nxjerrja e urdhërit të detyrueshëm për zbatim, të ish ministrit të shtetit për inovacionin dhe administratën publike nr 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", që DPT Tiranë të nxirrte në zbatim të tij, urdhërin nr 25, datë 24.04.2017 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata tatimore".

Bazuar në këtë urdhër të DPT-së, komisioni i posaçëm i ngritur në zbatim të tij, në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të gjyqfituesve (të cilat janë shpesh herë shumë të pakta, krahasuar me numrin e tyre) i propozon ish nëpunësit civil (në rast se është e mundëshme), sistemimin në një pozicion pune të të njëjtit nivel dhe kategori, në zbatim të dispozitivit të vendimit gjyqësor "titull ekzekutiv".

Çuditërisht vetëm pasi ish nëpunësi civil, shpreh pëlqimin për sistemimin në pozicionin e propozuar të punës, komisioni i posaçëm i DPT- së, i drejtohet DAP-it me akt rekomandimin

përkatës, për emërimin e tij në këtë pozicion. Po në rast se ish nëpunësit civilë, zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, nuk kërkojnë të rikthehen në punë apo nuk e japin pëlqimin për pozicionin e punës që ju ofrohet në bazë të këtij urdhëri të sipërcituar (gjë e cila ka nivel shumë të lartë probabiliteti), çfarë duhet të ndodh?! Fatkeqësisht nëse ndodh kështu, në mënyrë krejtësisht të paligjshme bazuar në këtë urdhër, ndërpritet vazhdimi i mëtejshëm i procedurës përkatëse ligjore dhe të gjithë ata që refuzojnë rikthimin në pozicionin e propozuar të punës konformë vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, lejohen padrejtësisht në dëm të taksapagueve shqiptarë, të vazhdojnë të trajtohen me dëmshpërblimin përkatës në mënyrë krejt të pakufizuar në kohë (deri sa të jetojnë), ndërkohë që ligjërisht vazhdimi dhe përfundimi i kësaj procedure ligjore, duhet ta ndërpres menjëherë këtë dëmshpërblim financiar.

Përveç sa më sipër, vonesa shumë e gjatë kohore dhe plotësisht e pajustificuar, në lidhje me ngritjen e këtij komisioni të posaçëm nga ana e DPT-së, të ngarkuar sipas urdhërit të sipërcituar me detyrimin ligjor të gjetjes së mundësive dhe vazhdimin të procedurave përkatëse në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të ish nëpunësve civilë, konformë vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, ngarkon me përgjegjësi ligjore, financiare dhe administrative, drejtuesit kryesor të kësaj drejtorie të përgjithshme, si dhe ata respektiv të drejtorive të saj juridike, apo të burimeve njerëzore.

Të dhënat statistikore të deritanishme tregojnë se, zbatimi i akteve të mësipërme nënligjore, të nxjerra me shumë vonesë sikurse themi më sipër, jo vetëm nuk e ka zgjidhur këtë problematikë shumë të rëndësishme në aspektin ligjor, ekonomik, financiar, social e të tjera, por përkundrazi e ka vështirësuar e përkeqësuar edhe më tej atë. Kështu për shembull, nëse janë rikthyer në marrëdhënie pune në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rreth 10 – 15% e numrit të ish nëpunësve civilë të administratës tatimore qendrore, të larguar më parë padrejtësisht nga puna pas vitit 2000, zotërues të vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, ende të pa ekzekutuara deri në fundin e vitit 2013 (kohë në të cilën hyri në fuqi ligji 152 / 2013), të paktën në periudhën e mëpasshme rreth 40% e këtij numri nëpunësish civilë të kësaj administrate që janë larguar nga puna, i janë shtuar listës së gjyqfituesve, përfitues të dëmshpërblimeve të majme financiare, qysh prej momentit të largimit përkatës nga puna, derisa të rikthehen në të ose të jenë gjallë nëse ky rikthim nuk do të ndodh. Bazuar në ligjin në fuqi 152 / 2013 “për nëpunësin civil” të ndryshuar, nenit 66/1, pika 1, në të cilin përcaktohet se vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, duhet të zbatohen menjëherë nga “njësia përgjegjëse” e cila në bazë të nenit 4, pika 1, shkronja f, të po këtij ligji është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, konstatohet fare qartë se në rastin që analizojmë: DPT dhe DAP (ashtu sikurse edhe shumë institucione të tjera, që e kanë këtë problematik), janë plotësisht jo efektive përsa i takon ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të kësaj natyre.

### **Disa këshilla e rekomandime, për minimizimin e dëmit financiar nga statusi i nëpunësit civil.**

Nisur nga fakti që përgjatë 17 viteve të fundit të veprimit të ligjeve nr 8549 datë 11.11.1999 “statusi i nëpunësit civil” dhe 152 / 2013 “për nëpunësin civil” të ndryshuar, buxheti i shtetit shpenzon çdo vit miliona euro për dëmshpërblimin, që rrjedh nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të ish nëpunësve me status të larguar më parë nga puna, në rolin e një ekonomisti finance me përvojë të gjatë pune në këtë profesion e mësimdhënie, duke qenë i obliguar të kontribuoj profesionalisht në favor të interesit publik, kam bërë publike përgjatë vitit 2017, përmes mediave të ndryshme vendase dhe paraqitur paranë institucioneve kryesore ligjzbatuese të vendit tonë, përmes faqeve të tyre zyrtare elektronike, disa mendime, këshilla dhe rekomandime ekonomiko – ligjore, të cilat nëse do të zbatohen do të çojnë në

minimizimin e këtij dëmi financiar sistematik e të përvitshëm, duke bërë të mundur që paratë e taksapaguesve, të mos përdoren për pagesa inproduktive e parazitare, por t'ju rikthehen atyre, në formën e investimeve publike, mallrave dhe shërbimeve qeveritare, rritjes së rrogave dhe pensioneve, politikave më të mira sociale e të tjera.

Meqëse institucione të ndryshme shtetërore (sistemi tatimor qendror, doganat në pjesën më të madhe të pozicioneve të punës, ministri, bashki e tjera), që gëzojnë ligjërisht statusin e nëpunësit civil për punonjësit e tyre, kanë specifika të ndryshme, jam përqëndruar në zgjidhjen e këtij problemi në sistemin tatimor qendror, që përbëhet nga: DPT-Tiranë, 13 DRT, DTM- Tiranë e tjera, ndërkohë që kjo zgjidhje mund shërbejë si model edhe për institucione të tjera me status, në vartësi me veçoritë që ato kanë.

**Së pari:** Duhet të bëhet rregullimi përkatës ligjor, duke ngarkuar me përgjegjësi financiare, administrative dhe/ose penale autoritetet përkatëse vendimmarrëse, për largime të padrejta nga puna, të konfirmuara përmes vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me periudhat respektive nga datat e largimit, deri tek ato të marrjes formë të prerë të vendimeve gjyqësore dhe për moszekutim në kohë të këtyre të fundit, prej datave përkatëse që duhet të realizohet përmbushja e këtij detyrimi ligjor, deri në ato të ekzekutimit të këtyre vendimeve, apo në vazhdim për pjesën e mbetur të tyre ende të paekzekutuar.

Zbatimi i pjesës së parë të këtij rekomandimi, që lidhet me largimet nga puna të ish nëpunësve civilë dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore përkatëse deri në marrjen formë të prerë të vendimeve gjyqësore në favor të tyre, duhet të analizohet me shumë kujdes dhe objektivitet, pasi periudha e deritanishme e funksionimit të sistemit të drejtësisë, është mbushur me raste të shumta kontestimesh, gjykimesh jo korrekte të ndershme e profesionale, të shoqëruara me ngjarje e fenomene korruptive, të denoncuar edhe prej emisioneve televizive investigative si “Fiks- Fare”, “Stop”, “Boom” e të tjera. Lidhur me atë çka themi, le të shpresojmë se funksionimi në të ardhmen i strukturave të reja të sistemit të drejtësisë, të dala nga implementimi i reformës në drejtësi, do të ndryshojë në drejtimin e duhur realitetin përgjithsisht negativ të funksionimit të deritanishëm të këtij sistemi. Gjithashtu këto autoritete, në përkatësi të institucioneve që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duhet të mbajnë përgjegjësinë e sipërcituar, në të gjitha ato raste kur sipas verifikimeve përkatëse, rezulton se kanë bërë emërime në punë nga jashtë ose brenda sistemit, në ato pozicione pune tek të cilat ato duhet të rikthenin detyrimisht, ish nëpunësit përkatës, zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmonin më parë këtë të drejtë, duke lejuar në këtë mënyrë vazhdimin abuziv të pagimit inproduktiv të këtyre të fundit, me fondet përkatëse publike të buxhetit të shtetit, deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, sikurse përcaktohet në këto vendime gjyqësore, ose derisa të jenë gjallë nëse ato nuk ekzekutohen.

**Së dyti:** Për të gjithë ish nëpunësit tatimor, të larguar më parë nga puna dhe për të cilët aktualisht ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, duhet të fillojnë menjëherë nga ana e DPT-së dhe DAP-it Tiranë, procedurat e rikthimit të tyre në punë, duke i kërkuar paraprakisht qeverisë në mënyrë të argumentuar, miratimin e një shtese organike për aq sa nevojitet, në përmbushje të detyrimit përkatës ligjor, që rrjedh edhe nga zbatimi i ligjit 152 / 2013 “për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 7, pika 2, shkronja gj. Përfshirja e rreth 10.000 subjekteve të biznesit të vogël me xhiro vjetore mbi 2 deri 5 milion lekë të reja, në skemën ligjore të tvsh-së, duke filluar prej datës 01.04.2018 e në vazhdim, do të kërkojë përveç të tjerash, shtimin e organikës së administratës tatimore qendrore mbi numrin 1586 që ajo është aktualisht, në mënyrë që të bëhet i mundur jo vetëm përpunimi, azhurnimi, gjurmimi dhe ndjekja e informacionit përkatës tatimor, por edhe kontrolli i vazhdueshëm tatimor i tyre në përputhje me legjisllacionin tatimor në fuqi.

Është plotësisht e mundur që kjo shtesë organike, jo vetëm të mos çënojë aspak me kosto shtesë financiare buxhetin e shtetit, por përkundrazi të gjenerojë të ardhura shtesë të konsiderueshme

për të. Kjo gjë bëhet plotësisht e mundshme, nëse realizohet rikthimi në punë i ish nëpunësve tatimorë të larguar më parë padrejtësisht nga puna, duke ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmojnë këtë të drejtë, ndërkohë që shtesa organike e miratuar më parë sikurse themi më sipër, duhet të jetë jo më e vogël se numri përkatës i këtyre të fundit.

Menjëherë pas këtij miratimi, ministria e financave konformë procedurave përkatëse ligjore, duhet të transferojë fondin përkatës të parashikuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime të kësaj natyre, në fond pagash për llogari të DPT-Tiranë, duke shtuar pjesën kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguhet nga punëdhënësi (shteti) dhe rritjen totale respektive të pagës bruto krahasuar me më parë.

Ky transferim është tepër i rëndësishëm, pasi ai bën të mundur zvëndësimin e shpenzimeve buxhetore inproduktive me ato produktive, pasi këto të fundit në çdo rast do të krijojnë të ardhura shtesë nga punësimi për llogari të buxhetit të shtetit, ndërkohë që ndryshesa (rritja / ulja) e shpenzimeve faktike në kuadrin e këtij buxheti, do të jetë e barabartë me pjesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguaj punëdhënësi (shteti) në zbatim të legjislacionit përkatës, plus rritjen totale respektive të pagës bruto, krahasuar me më parë për të gjithë ish nëpunësit e rikthyer faktikisht në punë, minus pjesën e dëmshpërblimit financiar të ndërprerë për ata ish nëpunës, të cilët sikurse themi më poshtë lirohen apo largohen nga shërbimi civil. Përlllogaritet se vlera e çdo dëmshpërblimi financiar të ndërprerë, është përafërsisht e mjaftueshme për të mbuluar koston shtesë buxhetore të rikthimit dhe vazhdimin në punën e mëparshme, të katër ish nëpunësve zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmonin më parë këtë të drejtë. Kjo do të thotë se vlera e dëmshpërblimit, që i korrespondon 20% të numrit total të ish nëpunësve tatimorë të kësaj kategorie, të cilëve për shkaqet e përmëndura më poshtë ju ndërpritet dëmshpërblimi financiar, është e mjaftueshme për të përballuar koston shtesë buxhetore të rikthimit dhe vazhdimin në punën e mëparshme, të të gjithë pjesës tjetër të barabartë me 80% të numërit total të tyre, ndërkohë që nëse shifra e mësipërme e daljes nga skema e dëmshpërblimit financiar është mbi 20%, atëherë gjenerohet përfitim shtesë buxhetor në formën e kursimit të shpenzimeve përkatëse të këtij buxheti.

Nëse për këtë kategori ish nëpunësish, kryhen procedurat përkatëse ligjore të rikthimit në punë dhe për këtë bëhet njoftimi zyrtar i secilit prej tyre, atëherë ndërpritet menjëherë dëmshpërblimi financiar i sipërpërmendur, pasi në këtë moment madje edhe kur ekzistojnë arsye të justifikuara ligjore për mosparaqitje në punë, efektet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nulifikohen (zerohen), ndërsa të gjithë ata që paraqesin aktin e dorëheqjes me shkrim, apo për arsye të ndryshme të pajustificuara ligjore nuk e respektojnë këtë vendimmarrje, lirohen apo largohen respektivisht nga shërbimi civil dhe numri i tyre i zbritet atij të strukturës së shtuar organike të personelit, duke e fiksuar atë përkohësisht në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

Në përfundim të këtij procesi, do të jetë tepër e sigurt, se numri i ish nëpunësve të kësaj kategorie që do të vazhdojnë të paguhen, do të jetë më i vogël nga ai i mëparshëm, madje me një ndryshim thelbësor tepër të madh, pasi këta të fundit nuk do të paguhen më në mënyrë inproduktive e parazitare, por nëpërmjet punës e cila padyshim dhe për çdo rast, do të gjenerojë nëpërmjet produktivitetit përkatës, përfitim shtesë me interes publik. Në lidhje me këtë, ka shumë të ngjarë që pjesa më e madhe e atyre, që kanë emigruar jashtë vendit (në Europë, SHBA, apo kontinente të tjera), apo që kryejnë punë të tjera ose merren me biznes, nuk do të preferojë të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, ndërkohë që padyshim ju intereson vazhdimi sa më gjatë në kohë i përfitimit parazitare të dëmshpërblimit ekonomik, që rrjedh nga mos kryerja e procedurave përkatëse ligjore të rikthimit në punën e mëparshme, konformë vendimeve gjyqësore përkatëse të formës së prerë. Aktualisht janë rreth 380 ish nëpunës të sistemit tatimor të larguar nga puna pas vitit 2000, për të cilët ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, por që ende figurojnë të pakthyer në punën e mëparshme. Ky fakt, përbën

një dëm të madh ekonomik të përvitshëm që i bëhet buxhetit të shtetit dhe taksapaguesve shqiptarë, pasi secili prej tyre ka përfituar dhe përfiton çdo vit, në vartësi me pagën përkatëse që ka patur, një shumë prej 9-10 milion lekësh të vjetra, pa dhënë asnjë llojë kontributi në punë. Duke qënë kështu, kuptohet fare qartë që shumicës së tyre apo ndoshta të gjithëve, nuk i intereson rikthimi në punën e mëparshme, madje mund ta konsiderojnë si një nga fatkeqësitë më të madha, nëse një gjë e tillë u ndodh, pasi ata mund të bëjnë punë të tjera (qoftë edhe në sektorin publik) dhe paguhet për to, të merren me biznese, e tjera, apo të emigrojnë jashtë vendit për vite të tëra dhe deri sa të arrijnë moshën e pensionit ose të jenë gjallë (gjë e cila nuk përbën aspak çudi), të paguhet duke shtuar çdo vit në llogarinë bankare të çdonjërit prej tyre, shumën prej rreth 10 milion lekësh. Përvoja e deritanishme ka treguar se kjo pagesë, mund të vazhdojë pandërprerje deri në më shumë se 40 vjetë rresht, duke kapur shifrën e mbi 400 milion lekëve. Në këtë situatë, rikthimi i tyre në punë sa më shpejtë që të jetë e mundur (qoftë edhe me shtesë organike), jo vetëm që e ndërpret efektin përkatës negativ në buxhetin e shtetit, por përkundrazi mundëson lëvizjen e tij drejt kahut pozitiv, pasi kontributi (produktiviteti) i punës së tyre në sistemin tatimor, i cili ende karakterizohet nga një nivel i lartë evazioni fiskal, do të shoqërohet me siguri në kushtet e mirëmenaxhimit të këtij sistemi, me një rritje të ardhurash për buxhetin e shtetit disa herë më shumë se rrogat përkatëse të tyre, të cilat vazhdojnë t'i marrin sistematikisht në periudha periodike vjetore, në mënyrë inproduktive e parazitare, madje dhe pa zbritur më parë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sikurse ndodh me të punësuarit.

Pra zbatimi i kësaj skeme ekonomiko-ligjore në çdo lloj rasti dhe rrethane, do të rezultojë me efekte financiare pozitive për buxhetin e shtetit dhe do të ulë nga ana tjetër, treguesin në % që zë kostua reale vjetore e mbajtjes së personelit të administratës tatimore qendrore, (të cilës i shtohet edhe dëmshpërblimi vjetor i sipërcituar), ndaj totalit të të ardhurave vjetore që vilen prej kësaj administrate, ndërkohë që vonesat subjektive të pajustificuara nga ana ligjore, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (për sa i takon rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, të ish nëpunësve përkatës të larguar më parë nga puna), apo akoma më keq mosekzekutimi fare i tyre, do të vazhdojnë të ndëshkojnë financiarisht këtë buxhet dhe taksapaguesit shqiptarë. Mundësia e rikthimit në punë, për raste të tjera të ngjashme, qoftë edhe me shtesë organike deri në masën ku të ardhurat e produktit marxhinal të punës barazojnë çmimin e saj (pagën), sikurse përcakton shkenca e ekonomisë, duhet të shikohet me përparësi edhe në institucione të tjera ku vepron ligji përkatës “për nëpunësin civil”, duke përfshirë edhe njësitë e qeverisjes vendore.

Në këndvështrimin ligjor, ekonomik, financiar dhe social, çdo shtesë organike e miratuar konformë procedurave përkatëse ligjore, që do të mundësonte rikthimin në punën e mëparshme të ish nëpunësve të kategorisë së lartpërmendur, do të ishte e justifikuar deri në masën që treguesi ekonomik “të ardhura të produktit marxhinal të punës”, të jetë jo më i vogël se pjesa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi (në rastin tonë shteti), në zbatim të legjislacionit përkatës, plus rritja respektive e pagës bruto krahasuar me më parë, pasi pjesa tjetër e shpenzimeve që lidhet me pagën, mbulohet financiarisht nga fondi përkatës i parashikuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime dhe i transferuar më parë në fond pagash, sikurse themi më sipër.

**Së treti:** Është e domosdoshme dhe emergjente që në kuadrin e rregullimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në fushën e shërbimit civil e të tjera, të përcaktohet qartë se nëse përgjatë periudhës kur ishpunonjësi civil apo jo civil, është trajtuar apo trajtohet me dëmshpërblim financiar nga fondet e buxhetit të shtetit për shkak të ekzekutimit të vendimit përkatës gjyqësor të formës së prerë në favor të tij dhe nga ana tjetër brenda kësaj periudhe, verifikohet se ai ka qenë apo është i punësuar në sektorin publik dhe për pasojë i paguar prej fondeve publike buxhetore, atëherë këto shuma pagesash duhet t'i zbriten atij prej

dëmshtëpërblimit të pritshëm, ose të kërkohet rikthimi i tyre në buxhetin e shtetit, përmes vendimit ekzekutiv të nxjerrë prej institucionit përkatës, konformë zbatimit të procedurave të nevojshme ligjore.

### **KLSH, institucion suprem i auditimit të zbatimit të legjislacionit dhe ruajtjes e mirëmenaxhimit të parasë e pronës publike.**

Nisur nga dëshira e mirë për të kontribuar në zgjidhjen sa më efçente të kësaj problematike tepër të rëndësishme dhe komplekse në aspektin ligjor, ekonomik – financiar, social, moral, politik e shoqëror, (sikurse themi më sipër), para disa kohësh (përgjatë vitit 2017), përmes adresave përkatëse elektronike të DAP-it, DPT-së, DPD-së, Ministrisë së Financave, Kryeministrisë, Avokatit të Popullit, KLSH-së, dhe Presidentit të Republikës, kam dërguar opinonin, këshillat dhe sugjerimet e mia ekonomiko - ligjore, të cilat njëkohësisht i kam bërë publike, duke i botuar edhe në disa prej gazetave kryesore të vendit tonë, si dhe në revistën ekonomike “Monitor”. Megjithëse këto këshilla dhe sugjerime ekonomiko – ligjore, të cilat janë rezultat i një studimi të thelluar shkencor të kësaj problematike komplekse, me pasoja shumë të rënda negative për buxhetin e shtetit shqiptar (prej jo më pak se 10 milion euro çdo vit), do të çonin në minimizimin e dëmit financiar, nëse do të merreshin në konsideratë dhe zbatoheshin nga ana e institucioneve ligjvënëse dhe ligjzbatuese, fatkeqësisht me përjashtim të KLSH-së, nuk u morën në konsideratë, madje u anashkaluan dhe u nënvlerësuan ndoshta pa i lexuar fare, duke mos më kthyer në shënjë respekti dhe mirënjohje për këtë kontribut shkencor të dhënë në favor të interesit publik, qoftë edhe përgjigjen formale me tre shkronja “FLM”.

Nëse këto institucione të lartpërmendura (përveç KLSH-së), qoftë edhe në bashkpunim me specialistët përkatës të FMN-së (të cilët kanë asistuar në këtë periudhë ekspertimin e financave publike shqiptare dhe çuditërisht nuk kanë dhënë asnjë lloj rekomandimi zyrtar për zgjidhjen e kësaj problematike), disponojnë të paktën një skemë ekonomiko – ligjore më efçente se ajo e rekomanduar nga ana e ime, atëhere çfarë presin akoma që nuk e vënë në zbatim, ndërkohë që praktika e deritanishme e ndjekur prej tyre ku mbizotëron spontaniteti, pasiviteti dhe “gjumi letargjik”, jo vetëm nuk e minimizon dëmin financiar të shkaktuar prej të paktën 10 milion euro çdo vit, por përkundrazi tenton ta thellojë akoma më tej atë. Sqarojmë se i vetmi institucion, i cili i mirëpriti, studjojë dhe vlerësojë si të drejta, dobishme, shkencore dhe efçente këto rekomandime, që çojnë nëse zbatohen nga institucionet përkatëse shtetërore në minimizimin e dëmit financiar sistematik të përvitshëm, sikurse përmendet më sipër, ishte KLSH-ja që e ka përfshirë dhe vazhdon ta përfshijë këtë problematikë kontrolli, si pikë të veçantë e të rëndësishme të programeve audituese, të cilat janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen, veçanërisht pranë institucioneve të administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit “për shërbimin civil”. Pavarësisht nga sa themi, implementimi i plotë i rekomandimeve të lartpërmendura të karakterit ekonomik – ligjor, të cilat optimizojnë zgjidhjen e kësaj problematike të ndërlikuar dhe komplekse duke i përdorur instrumentat përkatës deri në shterim, kërkon përveç të tjerash përmirësime të mëtejshme ligjore dhe meritojnë të merren në konsideratë dhe diskutohen prej komisioneve parlamentare të ekonomi – financës dhe atij të legjislacionit, përndryshe këto këto të fundit, (ndonëse me shumë vonesë), duhet të gjëjnë zgjidhjet e duhura përkatëse. Bazuar në të gjithë informacionin kompleks e transparent, të përditësuar dhe publikuar nga ana e KLSH-së në faqen e saj zyrtare; vlerësimet e shumta pozitive, të bëra prej përfaqësuesve zyrtarë të institucioneve supreme audituese (SAI) të vendeve të ndryshme partnere të botës (duke përfshirë edhe ato të disa prej vendeve të zhvilluara); rezultatet e larta me impakt pozitiv edhe për të ardhmen, të arritura në fushën e gjetjeve, zbulimeve, luftës kundër korrupsionit e evazionit fiskal, dhënies së rekomandimeve ndaj subjekteve të audituara, qeverisë dhe kuvendit, në funksion të përmirësimeve të mëtejshme të performacës (sidomos të institucioneve të shërbimit publik), legjislacionit e të tjera (veçanërisht përgjatë periudhës kur ky institucion drejtohet nga zoti Leskaj), rezulton se KLSH (ALSAI)

nuk është vetëm institucion suprem i auditimit të zbatimit të legjislacionit, ruajtjes e mirëmenaxhimit të parasë e pronës publike, në përputhje me parimet kyçe të auditimit (pavarësia, ligjshmëria, paanëshmëria, profesionalizmi, transparencë, konfidencialiteti, interesi publik, ekonomikiteti, efikasiteti, efektiviteti, etj) dhe standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI, EUROSAT, INTOSAT), pasi ai nuk auditon thjesht performancën e të tjerëve, por udhëheq institucionalisht me performancën e tij.

Nisur nga sa më sipër, shpreh bindjen se funksionimi në të ardhmen i strukturave të reja të sistemit të drejtësisë, të karakterizuara nga ndershmëria, profesionalizmi, korrektesa dhe integriteti moral (në ndryshim rrënjësor nga sa më parë), do të bëjë të mundur që rezultatet pozitive të veprimtarisë së këtij institucioni të sipërcituar, të avancojnë më tej dhe të jenë akoma më të prekshme në favor të interesit publik.